



BASHKIA
SHKODËR



PLANI LOKAL I MBROJTJES SE BIODIVERSITETIT

RISHIKIM

DREJTORIA E MJEDISIT DHE ENERGJISE SE RINOVUESHME

Tetor 2024



Akronime

SKMB	Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes së Biodiversitetit
PLMB	Plani Lokal i Mbrojtjes së Biodiveritetit
PPV	Plani i Përgjithshëm Vendor
VSM	Vlerësimi Strategjik Mjedisor
VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
PMZM	Plani i Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura
BSH	Bashkia Shkodër
NjA	Njësi Administrative
AKP	Agjencia Kombëtare e Pyjeve
AKM	Agjensia Kombëtare e Mjedisit
ZM	Zonë e Mbrojtur
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
MP	Toka të murrme pyjore
LM	Toka livadhore malore
SACs	Zonat me Interes të Veçantë Ruajtje për Bashkimin Evropian
SCI	Zonat me Interes të Veçantë Ruajtje nën Koventën e Bernës
SPAs	Zonat e veçanta të ruajtjes së shpendëve
UNESCO	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Edukimin, Shkencën dhe Kulturën
UNEP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin
IUCN	Unioni Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës
RAMSAR	Konventa për Ligatinat me Rëndësi Ndërkombëtare - Konventa e Ramsarit
MgjKShE	Moratoriumi i Gjuetisë së Kafshëve e Shpendëve të Egra
UNFCCC	Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara mbi Ndryshimet Klimatike
SWOT	Analizë e pikave të forta, të dobëta, mundësive dhe rreziqeve



Permbajtja

Hytje	4
Metodologjia.....	6
I. ANALIZA E PËRGJITHSHME E GJENDJES SË BIODIVERSITETIT NË TERRITORIN E BASHKISË SHKODËR.....	7
Veçoritë fiziko- klimatike të territorit.	7
Vlerat e biodiversitetit në territorin e Bashkisë Shkodër.....	13
<i>Liçeni i Shkodrës.....</i>	<i>14</i>
<i>Lumi Buna.....</i>	<i>17</i>
<i>Parku Kombëtar “Alpet e Shqipërisë”</i>	<i>18</i>
<i>Laguna e Vilunit.....</i>	<i>19</i>
<i>Pyjet dhe Kullotat nën administrimin e Bashkisë Shkodër.....</i>	<i>20</i>
<i>Biodiversiteti Urban.....</i>	<i>22</i>
II. ZONAT E MBROJTURA, LLOJET, PRONËSIA DHE FORMAT E QEVERISJES	26
Zonat e Mbrojtura, sistemi kombëtar i kategorizimit dhe qeverisjes	26
Statusi i ZM në Bashkinë Shkodër. Aktivitete të lejuara dhe të ndaluara sipas ligjit	30
III. IDENTIFIKIMI I FAKTORËVE TË DEGRADIMIT DHE KËRCËNIMIT TË HABITATEVE DHE HUMBJES SË BIODIVERSITETIT	42
3.1. Identifikimi i Faktorëve Degradues	42
3.2 Identifikimi i sfidave të menaxhimit të pyjeve dhe kullotave në Bashkinë Shkodër. ..	43
3.3. Identifikimi i Faktor Kërcënues të Biodiversitetit në Territorin e Bashkisë Shkodër .	44
IV. SHFRYTËZIMI I QËNDRUESHËM I BIODIVERSITETIT OBJEKTIVAT, PLANI I VEPRIMEVE, PERFUNDIME DHE REKOMANDIME	49
4.1. Shfrytëzimi i qëndrueshëm i biodiversitetit	49
4.2 Objektivat strategjike të PLMB	52
4.3. Objektivat specifike afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata	53
Objektivat specifike afatgjata	54
Shtojca	58
Aneks 1: Lista e specieve të bimëve në pellgun ujor të shkodrës	59
Aneks 2: Lista e specieve të peshkut	62
Bibliografia.....	63
Foto te specieve	64
Korniza Ligjore dhe Prioritetet ne Fushën e Mbrojtjes së Biodiversitetit.....	69

Lista e figurave

Fig 1. Pozicioni gjeografik i Bashkisë Shkodër	7
Fig. 2. Harta e Rrezatimit mesatar vjetor	9
Fig. 3. Harta e rrezatimit vjetor. PPV Bashkia Shkodër	9
Fig. 4. Hartat e shpejtësisë mesatare të erës m/s.....	10
Fig. 5: Harta e diversitetit të faunës. Bashkia Shkodër	13
Fig. 6. <i>Pelecanus crispus</i> , D.Ulqini	15
Fig 7. Numri i shpendëve dimëruar të shpendëve ujorë dimëruar në Liqenin e Shkodrës.....	16
Fig 9. Harta e organizimit të hapësirës publike.	25
Fig.10. Harta e zonave të mbrojtura para vitit 2022	
Fig.11. Harta e zonave të mbrojtura para vitit 2022	26
Fig 12. Harta e zonave të mbrojtura në territorin e Bashkisë Shkodër	30
Fig 13. Harta e zonimit të Parkut Kombëtar “Alpet e Shqipërisë”	32
Fig 14. <i>Lilium albanicum</i> , iNaturalist	33
Fig 15. <i>Taxus baccata</i> , pixabay	33
Fig 16. <i>Lynx lynx</i> , AKZM	34
Fig. 17. Harta e Zonimit të Zonës së Mbrojtur të Liqenit të Shkodrës.	35
Fig 18. Harta e Zonimit të Zonës së Mbrojtur të Liqenit të Shkodrës	36
Fig 19. Harta ekzistuese e zonave të mbrojtura “Lumi Buna-Velipojë”	38
Fig. 20. Harta e propozuar e zonimit të zonës së Mbrojtur “Lumi Buna –Velipojë”	39
Fig. 21. Harta e zonimit të Parkut Natyror “Lugina e Shalës”	41

Lista e tabelave

Tabela 1. Shpërndarja e mesatare ditore të rrezatimit global për 26 stacione meteorologjike.	8
Tabela 2. Treguesit e cilësisë së ajrit dhe normat e BE-së	12
Tabela 3. Treguesit ndër vite për qytetin e Shkodrës (Raportet e Gjendjes Mjedisore, AKM) ...	12
Tabela 4. Numri i monumenteve natyrore në Qarkun Shkodër.....	13
Tabela 5. Numri i individëve dhe i specieve të shpendëve ujorë dimëruar në Liqenin e Shkodrës, International Waterbird Census	16
Tabela 6. Sipërfaqet pyjore dhe kullosore, sipas listës së inventarit, të	21
transferuara në pronësi të Bashkisë Shkodër.....	21
Tabela 7. Inventari i sipërfaqeve të lulishteve dhe rrethrotullimve	24
Tabela 9. Lumi Buna dhe territoret ligatinore – Sipërfaqet në ha.....	37
Tabela 10. Sipërfaqja e PN-së, e përshkruar sipas mbulesës	39
Tabela 11. Analiza SWOT për biodiversitetin. Bashkia Shkodër.....	47



Hyrje

Plani Lokal i Mbrojtjes së Biodiversitetit është një dokument strategjik për ruajtjen e shumëllojshmërisë së gjallesave dhe ekosistemeve që ndodhen në territorin e Bashkisë Shkodër. Ky plan është i pari i hartuar në nivel vendor, i cili vjen në funksion të Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes së Biodiversitetit, në përmbushje të politikave kombëtare të mbrojtjes së biodiversitetit dhe në zbatim të strategjisë së Planit të Përgjithshëm Vendor për ruajtjen e mjedisit në territorin e Bashkisë Shkodër. Ky plan ka si qëllim rregullimin e përdorimit të qëndrueshëm të biodiversitetit nëpërmjet integritetit të elementëve kryesore të biodiversitetit në strategjitë, planet, programet dhe vendimmarrjet e të gjitha niveleve.

Plani vjen i rishikuar pas një periudhe 7 vjeçare të zbatimit të tij. Gjate kësaj periudhe kemi situata apo të dhëna të reja ne raport me biodiversitetin e zonës dhe aktivitetet apo projektet e ndërmarra në territorin e bashkisë Shkodër dhe jo vetëm. Plani synon të paraqesë një panoramë të re të gjendjes aktuale të biodiversitetit dhe të marre parasysh angazhimet e duhura për të mbrojtur biodiversitetin e zonës.

Plani i Përgjithshëm Vendor dhe Vlerësimi Strategjik Mjedisor i tij, mbeten dy dokumente baze të ne të cilat mbështet apo merr ne konsiderate ky plan. Ne këto dokumente strategjik të zhvillimit të territorit të Bashkisë Shkodër janë identifikuar problematikat mjedisore që kanë impakt negativ në biodiversitetin e Bashkisë Shkodër dhe marrin ne konsiderate që zhvillimi i territorit të bashkisë Shkodër të jetë në përmbushje të kriterëve të zhvillimit të qëndrueshëm ne funksion të mbrojtjes së mjedisit të në përgjithësi dhe të biodiversitetit ne veçanti. Zhvillimi i qëndrueshëm dhe shumë funksional i burimeve pyjore dhe kullimore që sigurojnë shtimin e sipërfaqeve pyjore rrisin prodhimtarinë dhe aftësinë ripërtëritëse të pyjeve, parandalojnë degradimin e mëtejshëm të tokës, mbrojnë biodiversitetin e sigurojnë potencial maksimal për të përmbushur funksionet ekologjike, ekonomike dhe sociale në nivel lokal, kombëtar dhe global pa cënuar ekosisteme të tjera.

Plani vjen edhe si një përmbushje e detyrimit ligjor që bashkia Shkodër, si pushtet vendor ka në ruajtjen e biodiversitetit të përcaktuar në nenin 27 pika 6 të Ligjit nr 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” i ndryshuar si edhe ligjet sektoriale si ligjin nr.9587, datë 20.7.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, të ndryshuar., Ligji nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”i ndryshuar, etj

Ndër të tjera ky plan vjen edhe si një detyrim që Shqipëria ka ndaj marrëveshjeve të nënshkruara me konventat ndërkombëtare në ruajtjen e mjedisit apo të biodiversitetit, ku mund të përmendim Konventën e Biodiversitetit - 1994, Konventën e Rios 05.01.1994 - Larmia biologjike, Konventa e Bernës - Konventa për ruajtjen e jetës së egër dhe habitateve natyrore të Evropës, Konventën Ramsar , Konventën e Aarhusit, etj.

Qëllimet kryesore të Planit Lokal të Veprimit për Biodiversitetin për Bashkinë e Shkodër janë renditur si me poshtë:

1. Përcaktimi, vlerësimi i gjendjes së natyrës në hapësirën administrative të bashkisë Shkodër, por dhe më gjerë në Qarkun e Shkodrës;
2. Vlerësimi i problemeve dhe rreziqeve që i kanosen pasurive natyrore dhe larmisë biologjike në veçanti si dhe vlerësimi i cilësisë së jetës në përgjithësi;
3. Përcaktimi i strategjive specifike dhe aktiviteteve për uljen e rreziqeve nga ata më serioze në dëmtimin e vlerave të biodiversitetit;

4. Përmirësimin e situatës së përgjithshme ekologjike në Bashkinë e Shkodër dhe në Rajonin e Shkodrës në përgjithësi, nëpërmjet përcaktimit të masave konkrete, strategjive mjedisore më efikase;

5. Rritjen e vetëdijes dhe përgjegjësisë qytetare për ruajtjen e vlerave të biodiversitetit, të rritjes së përkrahjes së komunitetit për aksione dhe investime ekologjike;

6. Rritjen e cilësisë së vetëqeverisjes lokale dhe përfshirjes së shoqërisë civile, për qeverisjen me programe miqësore me mjedisin si dhe zbatimin e tyre, promovimin e vlerave të biodiversitetit, tërheqjen e donatorëve për financimin e projekteve etj.

Ky plan hartohet në nivel lokal nga Bashkia Shkodër. Zbatimi i këtij plani është konceptuar që të mbështetet në metodën gjithëpërfshirëse ku çdo individ i komunitetit të ketë të drejtën e dhënies së kontributit të tij në këtë proces.

Metodologjia

Ky dokument bazohet në planin ekzistues të Mbrojtjes së Biodiversitetit në Bashkinë Shkodër për periudhën 2017- 2024, i miratuar me Vendim të Keshillit të Bashkisë..nr 16 dt 01.03.2017. Rishikimi i këtij plani konsiston në vlerësimin e gjendjes aktuale të biodiversitetit dhe të dhënave të përgjithshme fizike, klimatike apo të zhvillimit të përgjithshëm të territorit të bashkisë Shkodër. Në vlerësimin e këtij dokumenti do të merren parasysh të gjitha ndryshimet ligjore të ndodhura gjatë kësaj periudhe dhe analizimi i situatës aktuale ligjore në funksion të mbrojtjes së biodiversitetit. Gjithashtu rishikimi i planit do të marrë në konsideratë dhe rivlerësojë të gjithë faktorët kërcënues të parashtruar në planin e mëparshëm. Dhe në mbyllje do të vlerësohen dhe propozohen planet e veprimit për secilin faktor kërcënues të vlerësuar.

Duke patur parasysh çdo element të planit ekzistues dhe vlerësuar çdo ndryshim të mundshëm plani i rishikuar do të ketë të njëjtën strukturë dhe të njëjtën qasje për vlerësimin dhe hartimin e Planit lokal të mbrojtjes së Biodiversitetit.

Përgatitja dhe hartimi i studimit “Plani Lokal për Mbrojtjen e Biodiversitetit” Bashkia Shkodër është një model i ndërtuar mbi bazën e një procesi dhe planifikimi gjithëpërfshirës.

Ky plan merr parasysh të gjithë studimet, raportimet zyrtare në lidhje me gjendjen e mjedisit dhe të gjitha dokumentet strategjike që lidhen me planifikimin e territorit apo të mbrojtjes së mjedisit.

I zhvilluar në pesë pjesë kryesore, “Plani Lokal për Mbrojtjen e Biodiversitetit” është konceptuar në kapitujt kryesorë: (i) Analiza e gjendjes së biodiversitetit në Bashkinë Shkodër; (ii) Zonat e mbrojtura, llojet, pronësia dhe format e qeverisjes; (iii) Identifikimi i faktorëve të degradimit të habitateve dhe humbjes së biodiversitetit; (iv) Plani i veprimit dhe (v) Rekomandimet. Duke u kujdesur në mënyrë të veçantë në ndërveprimet ndërmjet çështjeve të ndryshme, për secilën çështje paraqitet problematika dhe rekomandimet për ndërhyrjet konkrete.

Kështu, dokumenti trajtohet në një rrjedhë logjike, ku së pari përcaktohet dhe analizohet problemi, dhe më pas jepen rrugët e mundshme të zgjidhjes.



I. ANALIZA E PËRGJITHSHME E GJENDJES SË BIODIVERSITETIT NË TERRITORIN E BASHKISË SHKODËR

Veçoritë fiziko- klimatike të territorit.




Fig 1. Pozicioni gjeografik i Bashkise Shkoder

Pozita gjeografike

Bashkia Shkodër shtrihet në veriperëndim të Shqipërisë në një territor prej 873 km², i cili kufizohet në veri me Bashkinë e Malësisë së Madhe, në perëndim me Malin e Zi, në lindje me Bashkinë Tropojë, në jug me Bashkinë Vau i Dejës dhe me Bashkinë Lezhë.

Bashkia e Shkodrës përbëhet nga 11 njësi të qeverisjes vendore, (Shkodër, Ana e Malit, Bërdicë, Dajç, Guri i Zi, Postribë, Pult, Rrethinat, Shalë, Shosh dhe Velipojë).

Në veriperëndim të Bashkisë Shkodër ndodhet Liqeni i Shkodrës, i cili me një sipërfaqe prej 368 km² është liqeni më i madh në Ballkan. Nga ky liqen buron Lumi Buna (44 km), i cili derdhet në detin Adriatik dhe rrjedha e poshtme e të cilit ndan kufirin me Malin e Zi. Lumi Buna bashkohet me lumin Drin rreth 2 km në jugperëndim të qytetit.

Nga ana lindore qyteti kufizohet me Lumin Kir, i cili buron nga Malësitë e Veriut dhe është 43 km i gjatë. Ky lum derdhet në Lumin Drin që rrethon Shkodrën nga ana jugore.

Pjesa kryesore fushore e qytetit sot ka një shtrirje prej, 1150 ha, ndërsa pjesa kodrinore ka një shtrirje prej 350 ha.

Veçoritë fiziko- klimatike të territorit. Bashkia Shkodër

Klima në Bashkinë Shkodër është mesdhetare fushore, kodrinore, pjesërisht paramalore me gërshetime të natyrave detare e kontinentale, ndërkohë që në pjesën veriore është kontinentale malore. Ajo karakterizohet nga klime tipike mesdhetare me verë të nxehtë e të thatë dhe dimër relativisht të butë, me vjeshtë e pranverë të paqëndrueshme, si nga pikëpamja e reshjeve ashtu edhe e temperaturave. Ndërkohë zona verilindore karakterizohet nga dimër i ftohtë me rreshje dëbore, dhe verë të freskët.

Kushtet klimatike janë formuar nën veprimin e një sërë faktorësh. Në këtë aspekt mund të rradhisim:

- Prania e relievit të lartë malor të Alpeve Shqiptare në veri e lindje, prej nga zbresin erëra të ftohta si dhe mundësia që i japin këto male hapësirës së Shkodrës, të përfitojë nga kondensimi i avujve të ujit që ndodh në lartësitë dhe shpatet e tyre;
- Të prezencës së ndikimit detar nga perëndimi e jugperëndimi, por njëkohësisht edhe të rolit të relievit kodrinor të vargut Tepe-Kala-Tarabosh, që pengon pak ndikimin e lirshëm të puhisë detare;

- Depërtimi i erërave të ftohta që zbrasin nga malet e Mali të Zi, të cilat favorizohen nga ulja graduale e këtij relievi në formën e një lugu, që zbret drejt jugut për në fushën e Podgoricës dhe liqenit të Shkodrës;
- Nga pozicioni verior i qytetit në raport me hapësirat jugore të Ultësirës Perëndimore, ku bën pjesë qyteti i Shkodrës, gjë që reflektohet në intensitetin e rrezatimit diellor, nën qarkullimet e masave ajrore që ndërthuren apo alternohen gjatë periudhave të ndryshme të vitit, sidomos gjatë dimrit.
- Rol shumë të spikatur luajnë erërat lokale me karakteristike, si murlani dhe shiroku, që alternohen me periudha zakonisht dekadike gjatë dimrit, por dhe gjatë gjysmës së dytë të vjeshtës dhe gjysmës së parë të pranverës.

Rrezatimi diellor¹ paraqitet si faktor kryesor i formimit dhe i ndryshimit të klimës. Sasinë dhe efektin e energjisë diellore e përcakton këndi i rënies së rrezeve të diellit i cili varet nga gjerësia gjeografike dhe elementë të tjerë orografike, vranësirat.

Në qyteti e Shkodrës shpërndarja e orëve me diell shkon rreth 2300-2500 ore ne vit. Vlen të shënohet se rrezatimi diellor është një faktor i rëndësishëm klimatik që ndikon në krijimin e mikroklimës së qytetit të Shkodrës. Zona e Velipojës, dallohet për sasinë e madhe të orëve me diell që janë rreth 2500-2700 orë me diell në vit. Ndërsa në pjesën veriore të bashkisë, orët me diell shkon deri 2100 -2300 orë në vit.

Vlera më e lartë e zgjatjes faktike mujore të diellizimit është në muajin korrik, ku zgjatja astronomike e ditës është më e madhe, por qershori karakterizohet nga vranësira më të mëdha sesa korriku dhe gushti, prandaj edhe gushti ka më shumë orë me diell sesa qershori.

Tabela 1. Shpërndarja e mesatares ditore te rrezatimit global për 26 stacione meteorologjike.

Zona	Jan.	Shku.	Mar.	Pri.	Maj.	Qer.	Korr.	Gush.	Shta.	Tet.	Nen.	Dhj.	A.M.
Razem	1699	2286	3165	4120	5154	5803	6371	5602	4327	2930	1814	1481	3737
Shkodra	1734	2362	3343	4431	5442	6317	6571	5774	4444	2997	1840	1521	3918
Kukes	1428	2119	3010	4165	5275	6087	6340	5553	4121	2684	1609	1254	3647
Puke	1682	2299	3286	4223	5500	6266	6539	5889	4527	2941	1871	1490	3845
Lezhe	1791	2460	3429	4581	5604	6637	6900	6018	4644	3103	1989	1605	4071
Peshkopi	1613	2331	3229	4328	5303	6152	6448	5674	4355	2978	1812	1403	3808
Mamurras	1789	2426	3368	4484	5468	6307	6554	5810	4508	3018	1961	1569	3948
<i>Burreli</i>	1761	2404	3314	4421	5523	6183	6493	5659	4422	3034	1902	1505	3893
Kameza	1872	2522	3377	4537	5614	6512	6825	6019	4619	3229	2017	1588	4068
Tirana	1830	2468	3346	4468	5602	6477	6781	5990	4631	3190	1981	1546	4036
Durrësi	1840	2559	3504	4693	5730	6557	6802	6029	4751	3235	2018	1567	4115
Elbasani	1884	2535	3340	4417	5422	6243	6520	5837	4515	3167	2009	1615	3967
Lushnja	1873	2568	3459	4612	5742	6622	6834	5943	4576	3075	1999	1579	4082
Pogradeci	1735	2417	3266	4491	5511	6403	6712	5879	4444	3015	1949	1525	3953
Kuçova	1909	2585	3426	4646	5753	6616	6818	6041	4581	3187	2060	1656	4115
Fieri	1941	2654	3596	4863	5990	6946	7210	6358	4824	3324	2146	1705	4307
Sheqerasi	1736	2447	3339	4521	5520	6288	6694	5997	4575	3094	1920	1510	3984
Voskopoja	1719	2385	3218	4442	5530	6457	6718	5868	4441	3039	1973	1521	3948
Korça	1739	2463	3297	4426	5400	6296	6567	5783	4426	3029	2058	1520	3918
Gllava	1869	2543	3369	4243	5317	6009	6315	5679	4493	3137	2120	1638	3896
Vlora	1931	2618	3535	4757	5859	6753	6984	6117	4808	3293	2095	1680	4219
Erseka	1860	2600	3405	4465	5489	6375	6740	5795	4520	3140	1959	1674	4022
Gjirokastrë	1781	2466	3357	4529	5691	6601	6805	6000	4562	3096	2067	1533	4041
Borshi	1912	2544	3360	4482	5586	6411	6574	5903	4552	3149	2177	1625	4022
Saranda	1940	2620	3523	4625	5764	6559	6768	6003	4667	3250	2177	1746	4145
Xarra	1999	2636	3574	4679	5853	6703	6846	6088	4752	3282	2229	1789	4211

¹ AKBN / Energjia Diellore/ Potenciali i Energjise Diellore http://www.akbn.gov.al/images/pdf/energji-te-rinovueshme/Energjia_Diellore.pdf






Fig. 2. Harta e Rrezatimit mesatar vjetor Burimi : Instituti i Hidro-Meteorologjisë




Fig. 3. Harta e rrezatimit vjetor. PPV Bashkia Shkoder

Era

Njohja e klimës së Shkodrës është e lidhur ngushtë me njohjen e erërave karakteristike, sepse rrymat ajrore nuk janë vetëm një shfaqje e klimës, por mund të konsiderohen edhe një nga faktorët drejtues të saj. Regjimi i erërave është i lidhur ngushtë me regjimin sezonal, me pozicionin dhe shtrirjen e rrugëve si dhe me ndikimin e detit Adriatik. Erërat më karakteristike janë murlani e veriu, të ftohta e të thata, shiroku, e ngrohtë e me lagështi.

Në Shkodër fryjnë erëra që gjatë vitit ndryshojnë shpesh si drejtimin ashtu edhe shpejtësinë.

Drejtimi i erërave, ndryshon gjatë vitit, dhe në të ndikojnë faktorët lokale, afërsia me detin, drejtimi i vargmaleve dhe i luginave të lumit Kir dhe Drin.

Shpejtësitë e mëdha të ere janë gjatë dimrit, ato janë karakteristike edhe gjatë muajit mars. Gjatë periudhës së dimrit rrymat e shirokut ushtrojnë një ndikim të madh në shkrirjen e dëborës, duke shkaktuar fryrjen e liqenit dhe të lumenjve të Shkodrës, për pasojë krijimin e situatave të vështira përmbytëse si ato të vitit 2010.





Fig. 4. Hartat e shpejtësisë mesatare të erës m/s.

Temperatura mesatare shumëvjeçare në Shkodër është 14.8°C. Amplituda mesatare vjetore është 19.7°C. Deti Adriatik dhe liqeni i Shkodrës ushtron një ndikim zbutës, si ndaj ashpërsisë së dimrit ashtu edhe ndaj të nxehtit veror duke e zvogëluar në mënyrë të ndjeshme amplitudën. Të dhënat e tabelës së mëposhtme, na lejojnë të gjykojmë mbi ecurinë vjetore të temperaturës së ajrit. Kjo ecuri paraqet një maksimum dhe një minimum.


Maksimumi është në gusht ndërsa minimumi në janar. Variacioni mesatar ndër muajor d.m.th ndryshimet e temperaturës se një muaji të dhënë dhe të muajit të mëparshëm tregon se në përgjithësi ndryshime të theksuara nuk ka. Këto ndryshime vihen re në fillim të vjeshtës dhe të pranverës. Vlerat maksimale të këtij ndryshimi i gjejmë në periudhën shtator-tetor (5.2oC) dhe vlerat minimale në periudhën korrik- gusht (0.1oC).

Ecuria ditore e temperaturës së ajrit karakterizohet nga një maksimum në orët e para të pasdites dhe nga një minimum para lindjes së diellit. Veçoritë themelore të ecurisë ditore të temperaturës së ajrit jepen nga rrezatimi (insolacioni dhe rrezatimi tokësor të marra së bashku). Për sa i përket vlerave



mesatare një interes të madh si nga ana teorike dhe praktike, paraqesin njohja e vlerave skajore, ku meritojnë vëmendje maksimumet e minimumet absolute.

Ndërkohë në zonat malore temperaturat mesatare janë shumë herë më të ulta se ato në zonat perëndimore të Shkodrës. Gjatë periudhës Nëntor-Shkurt temperaturat mesatare variojnë midis -4/-5 dhe në periudha të caktuara mund të arrijnë në nivele shumë të ultë duke kaluar 20 °C.



Ndryshueshmëria rreth vlerave normale me disa periudha të dallueshme me tendenca të ndryshme gjate 15 viteve te fundit - (rritje e temperaturave ditore si në vlerat maksimale dhe minimale, veçanërisht në verë. Ndërkohë mbas 2000 për disa vite përqindja e rritjes se temperaturave minimale është më e lartë se ajo e maksimumit ne verë.

Lagështira e ajrit është një element tjetër i rëndësishëm, që së bashku me elementët e tjerë ndikon në krijimin e mikroklimës. Ardhja e masave ajrore me origjinë polare nga gjerësitë mesatare, shoqërohet me uljen e lagështirës, kurse ato me origjinë atlantike sjellin rritjen e përmbajtjes së lagështirës në ajër. Përmbajtja e lagështirës në ajër krijon kushte potenciale, për rënien e reshjeve, forcon ose dobëson veprimin e elementëve të tjerë meteorogjikë mbi njerëzit, botën bimore dhe shtazore. Vlerat më të larta të lagështirës relative të ajrit, vërehen në muajt nëntor dhe dhjetor, ndërsa vlerat më të ulëta të lagështirës relative vërehen në muajt korrik-gusht.

Megjithëse kushtet klimaterike në qytetin e Shkodrës, e favorizojnë copëtimin horizontal, sasia e reshjeve është e madhe. Sasia mesatare vjetore e reshjeve luhetet në 1800-1900 m/m, ndërsa sasia maksimale në vite të veçanta, arrin 3000 m/m. Kjo sasi shpjegohet me hapjen e territorit, nga perëndimi e jugperëndimi, prej nga vijnë masat ajrore detare të ngarkuara me avuj uji.

Qyteti i Shkodrës karakterizohet nga reshje të shumta, 2065 mm në vit, sasitë më të mëdha të reshjeve vërehen gjatë muajit nëntor (274 mm) dhe muajit dhjetor (280 mm), ndërsa muaji me i thatë është korriku me 42 mm. Në qytetin e Shkodrës brenda 24 orëve kanë rënë 130 mm reshje shiu, ndërsa për 30 minuta kanë rënë 80 mm reshje shiu.

Pasojë e reshjeve intensive janë vërshimet dhe përmytjet e mëdha të lumit Drin e Kir nga njëra anë dhe të liqenit të Shkodrës dhe lumit Buna nga ana tjetër, duke shkaktuar kushte anormale pune e banimi për banorët e prekur.

Trashësia e dëborës është e vogël dhe nuk qëndron gjatë, veçse në raste të jashtëzakonshme.

Trashësia maksimale e dëborës e regjistruar deri më tani është 40 cm. Breshëri është një dukuri e rrallë. Me breshër regjistrohen mesatarisht 4-5 ditë dhe me kohëzgjatje të shkurtër 10-12 minuta.

Shkodra karakterizohet nga reshje intensive me shira të vazhdueshëm kryesisht në formë shtërngate, me rrufe të rrezikshme madje me erëra të forta. Të gjitha këto duhet të merren parasysh në planifikimin e territorit dhe në procesin studimor të zhvillimit urban, si në projektimin e pallateve ashtu edhe në ndërtimin e banesave individuale. Është e rëndësishme të ndalohet ndërtimi pa kriter dhe jashtë kushteve urbanistike, si dhe të ketë një bashkëpunim mes urbanistëve, arkitektëve dhe meteorologëve.

AJRI: Në përgjithësi cilësia e ajrit në qytetin e Shkodrës konsiderohet brenda standardeve të BE. Kjo referuar matjeve zyrtare nga Agjencia Kombetare e Mjedisit. Këto standarde ndryshojnë në varësi të harqeve kohore. Në tabelën më poshtë paraqiten disa nga treguesit e cilësisë së ajrit, për të cilët kryhen monitorime pothuajse periodike, dhe standardet respektive të BE-së.

Tabela 2. Treguesit e cilësisë së ajrit dhe normat e BE-së


Normat e BE	PM ₁₀ µg/m ³	PM _{2.5} µg/m ³	SO ₂ µg/m ³	NO ₂ µg/m ³	O ₃ µg/m ³	CO mg/m ³	C ₆ H ₆ µg/m ³
1 orëshe			350	200			
8 orëshe					120	10	
24 orëshe	50		125				
Vjetore	40	25		40			5

Mbështetur në Raportet Kombëtare për Gjendjen e Mjedisit ndër vite, vlerat e treguesve të cilësisë së ajrit për qytetin e Shkodrës kanë pësuar luhatje, të cilat pasqyrohen konkretisht si më poshtë për çdo tregues.

Tabela 3. Treguesit ndër vite për qytetin e Shkodrës (Raportet e Gjendjes Mjedisore, AKM)

Treguesi (mesatare vjetore)	2016	2017	2018	2019	2020	2021
PM ₁₀ (µg/m ³)	16.63	25.07				
PM _{2.5} (µg/m ³)	12	22.74				
SO ₂ (µg/m ³)	8	6.39		11.73		
NO ₂ (µg/m ³)	10	12.29		9.65	14.57	
O ₃ (µg/m ³)	66.93	77.47		78.3		
CO (mg/m ³)	0.8	1.43		1.51		2
C ₆ H ₆ (µg/m ³)	2.91	2.91				

GRAFIKU I PARAMETRAVE TE CILESISE SE AJRIT SIPAS AKM



Nga të dhënat zyrtare të raporteve monitoruese të paraqitura më lart dhe grafikut përmbledhës, vihet re një mangësi e të dhënave për parametrat e cilësisë së ajrit sidomos vitet e fundit (2018, 2020-2021). Kjo mungese të dhënash të pengon për të patur një pasqyre të sakte të tendencës të ndryshimit të gjendjes së cilësisë së ajrit. Vitet 2020-2021 rezultojnë të jene vitet ku prania e pandemisë COVID mund të ketë përmirësuar cilësinë e ajrit megjithatë e dhëna për NO₂ rezultojnë të jene me larte në krahasim me vitet e mëparshme. Megjithatë duke vlerësuar të dhënat zyrtare të paraqitura me sipër na rezultojnë se parametrat mesatar të cilësisë së ajrit në qytetin e Shkodrës janë brenda standardeve të lejuara të BE. Si rrjedhojë, potencialet e rritjes së bimësisë në këtë rajon janë të konsiderueshme.



Vlerat e biodiversitetit në territorin e Bashkisë Shkodër

Biodiversiteti, si tërësi e llojeve dhe ekosistemeve tokësore e ujore në territorin e Bashkisë të Shkodrës, shfaq ndryshime midis zonave dhe habitateve. Në përgjithësi, e gjithë zona e administrative e Bashkisë Shkodër është e pasur në burime natyrore dhe diversitet të pasur të florës, faunës e habitateve. Kjo është e evidente veçanërisht në zonat e mbrojtura *Liqeni Shkodrës*, *Parku kombëtar “Alpet e Shqipërisë”*, *Peizazhi i mbrojtur Bunë-Velipojë*, të cilat kanë biodiversitetin më të pasur brenda territorit të Bashkisë. Llojet, gjenet, dhe ekosistemet janë prodhim i një evolucioni mbi tre miliard vjeçar, ndaj prishja e balancave mund të jetë me pasoja të rënda për gjithë ekosistemin dhe vetë njeriun.

Ne hartën e mëposhtme janë pasqyruar zonat me biodiversitetet me të larte duke veçuar shpërndarjen e disa nga specieve me kryesore përgjatë gjithë territorit.




Fig. 5: Harta e diversitetit të faunës. Bashkia Shkodër (Burimi: VSM i Planit te Përgjithshëm Vendor)

Siq shihet edhe nga harta territori i Bashkisë Shkodër është i mbuluar gjithandej me zona me biodiversitet të larte. Kjo dëshmohet mjaft mire edhe me sipërfaqet e zonave të mbrojtura, të cilat zënë rreth 50 % të sipërfaqes se Bashkisë Shkodër si dhe numri i konsiderueshëm i monumenteve natyrore, krahasuar edhe me bashkitë e tjera të qarkut Shkodër.

X	Shkodër	Shkodër	57
		Vau Dejës	3
		Fushë Arrëz	9
		Pukë	12
		Malësi e Madhe	34
	Totali		115

Tabela 4. Numri i monumenteve natyrore ne Qarkun Shkodër.

Liçeni i Shkodrës

Liçeni i Shkodrës është liçeni më i madh në Gadishullin e Ballkanit dhe shtrihet në kufirin ndërmjet Shqipërisë dhe Malit të Zi. Ekosistemi i liçenit dhe zonat ujore, ultësirat dhe formacionet karstike, ushqejnë faunën dhe florën e pasur dhe unike, duke e shndërruar atë në një qendër të rëndësishme biodiversiteti në Evropë. Zonat e shumta arkeologjike, historike dhe kulturore dëshmojnë për trashëgiminë e pasur kulturore të rajonit përreth Liçenit të Shkodrës që në kohët parahistorike. Aktualisht përgjatë basenit të Liçenit të Shkodrës jetojnë rreth 600,000 banorë, 170,000 prej të cilëve në pjesën shqiptare. Aktivitetet ekonomike në këtë rajon, në veçanti bujqësia, peshkimi, pylltaria, turizmi dhe rekreacioni, janë të lidhura ngushtë me përdorimin e burimeve natyrore të zonës, të cilat ndikojnë në ekosistemin e liçenit. Për të siguruar mbrojtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të ekosistemit të liçenit dhe të pasurive natyrore përreth tij, autoritetet Shqiptare dhe Malazeze kanë krijuar zona të mbrojtura, të cilat përfshijnë liçenin dhe pjesë të pellgut të tij.

Liçeni i Shkodrës është i njohur në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar për diversitetin e pastër të llojeve (florës dhe faunës) dhe habitateve ujore. Në këtë liçen janë regjistruar dhjetëra habitate, ku janë gjetur shumë shoqërime bimore dhe lloje dominante, pa lënë pas edhe një shumëllojshmëri peshqish dhe shpendësh. Diversiteti i lartë biologjik i dedikohet veprimit të faktorëve favorizues kryesisht të karakterit ekologjik-gjeografik. Ky diversitet habitatesh u jep strehë një numri të madh bimësh dhe kafshësh ku përfshihen disa tipe, nëntipe dhe shumë njësi klasifikimi më të vogla, si: lakustrine, palustrine, riverine, limnetike, litorale, emergjente, submergjente, notuese, pyll, shkurre, kaçube, bar etj.



Në Liçenin e Shkodrës njihen 850 specie bimore dhe 600 specie shtazore. Në vetvete, Liçeni përfaqëson një habitat të përmasave të mëdha, mjaft interesant, unik dhe shumë kompleks për shtegtimin e këtyre llojeve (Dhora, 2016). Karakteristikat unike të këtij liçeni kanë lidhje me regjimin e tij ujor, që ndryshon sipas stinëve, me luhatjen e vëllimit të ujit, deri në afër dyfish. Në stinën e verës në pjesën veriore, por edhe atë lindore e juglindore të liçenit, formohen cektina duke zhvilluar kështu sipërfaqe të përkohshme kënetore.

Liçeni i Shkodrës përfaqëson një zonë të ndërmjetme midis sistemeve tokësore dhe ujore. Gjatë një pjese të vitit tokat zhyten nën ujë, nga të cilat mund të zhvillohen kënetat dhe pyje kënetore. Nga pika më jugore e Liçenit në dalje të Bunës ku fillon Liçeni i Shkodrës, deri në Kepin e Radushës, Liçeni është shkëmbor-gëlqeror. Ai karakterizohet nga shumë gjire, kepe dhe ishuj të vegjël që kanë interes dhe rëndësi të veçantë në hidrologjinë dhe biologjinë e Liçenit, pasi janë mjedise relativisht të izoluar, me bimësi interesante, strehë dhe vende riprodhimi për shpendët dhe kafshët e tjera. Liçenin e Shkodrës mund ta konsiderojmë si një kompleks shumë të pasur



habitatesh. Sistemi i habitateve të Liqenit të Shkodrës është dinamik në raport me kohën.

Në stinën e vjeshtës dhe sidomos atë dimrit, kur volumi i ujit në liqen rritet, temperatura e ujit zbret dukshëm, turbullimi rritet prej erërave dhe shirave, bimësia pakësohet e si rrjedhojë larmia e habitateve zvogëlohet. Kjo është arsyeja që në dimër numri i habitateve në Liqenin e Shkodrës bie dukshëm. Fauna e liqenit është e pasur me lloje të kafshëve ujore, peshq e molusqe (Dhora, 2016). Në Liqenin e Shkodrës dhe ujërat e pellgut të tij ujëmbledhës janë gjetur 54 lloje molusqesh. Brenda në liqen janë gjetur 30 lloje krustacë nga 87 të tilla. Ato grupohen si 62 lloje të gaforreve të ulta dhe 25 lloje të larta. Prej studimeve të kryera numri i llojeve të insekteve në këtë pellg është vlerësuar të jetë rreth 6000, nga të cilat mbi 100 lloje janë endemike të këtij liqeni. Përsa u takon gjitarëve pellgu Ujëmbledhës i Liqenit të Shkodrës përmban 57 lloje gjitarësh, prej të cilëve 20 lloje të lakuriqëve të natës dhe 12 lloje brejtësish.

Resurset peshkore: Liqeni i Shkodrës është i njohur për larminë e llojeve të peshqëve objekt peshkimi. Sipas Dhora (2016), lista e peshqve (*Actinopterygii*) të Liqenit të Shkodrës dhe ujërave afluate përmban 52 specie. Familja Cyprinidae ka 25 specie, ose 48 % të totalit, çka konsiderohet përqindje e lartë dhe ky fakt e karakterizon liqenin dhe iktiofaunën e tij si ciprinidë. Ujërat përreth liqenit dhe iktiofauna e tyre janë salmonide. Në liqen janë gjetur 9 specie të familjes Salmonidae (17.3 %). Speciet autoktone të Liqenit të Shkodrës janë gjuca (*Alburnus scoranza*) dhe krapit (*Cyprinus carpio*) me vlerë të madhe për ekonominë lokale dhe më gjerë. Speciet migruese (përmes lumit Buna në Det) si kubla (*Alosa agone*), ngjala (*Anguilla anguilla*), qefulli i verës dhe qefulli i vjeshtës (*Mugil cephalus* dhe *Liza ramada*) janë resurse peshkore me rëndësi të veçantë. Krahas specieve rezidente dhe migratore në liqen janë introdiktuar edhe specie të tjera si karasi (*Carassius gibelio*) dhe sharmaku (*Perca fluviatilis*). Vlen për t'u theksuar se në pellgun ujëmbledhës Liqeni i Shkodrës, zënia e peshkut konsiderohet e madhe. Në komunitetin e peshqve ka dominancë të specieve vendase dhe prezencë të specieve ekzotike, por me impakt jo të madh. Më e përhapur është familja e krapit me 26 lloje dhe familja e troftave me 8 lloje. Te tjera janë familja e kavallëve ajo e blinëve, familja e kublave, familja e levrekëve, familja e burdullakëve, familja e ngjalave dhe familja e qefujve (Dhora, 2003). Lista e plotë e llojeve të peshqëve objekt peshkimi gjendet në *Anex 1 të këtij botimi*.

Shpendët: Liqeni i Shkodrës përfaqëson një ndër zonat me avifaunë më të pasur në Shqipëri. Në Liqenin e Shkodrës dhe pellgun e tij ujëmbledhës janë regjistruar 283 lloje shpendësh, prej të cilëve 168 janë të habitateve ujore. Në këtë liqen (në pjesën malazeze) gjendet një koloni e Pelikanit kaçurrel (*Pelecanus crispus*), lloj i cili mban statusin "gati i kërcënuar" (near threatened, NT) sipas IUCN-së. Liqeni i Shkodrës plotëson kriterin e Ramsarit për numrin e çifteve folezuese të *Chlidonias hybridus* dhe *Phalacrocorax pygmeus*. Ai është listuar në listën e ligatinave me rëndësi globale për numrin e lartë të shpendëve që dimërojnë në këtë zonë.



Fig 6. *Pelecanus crispus*, D.Ulqini

Pothuajse çdo vit në muajin janar, zhvillohet Numërimi Ndërkombëtar i Shpendëve Dimërues, me përfshirjen e Administratave të Zonave të Mbrojtura në të 12 qarqet e vendit. Metodologjia e ndjekur konsiston në përcaktimin e disa vendnumërimeve për çdo AdZM. Nga viti 2016 deri në vitin 2022, me përjashtim të viteve 2017 dhe 2018, numri i individëve dhe i specieve për Liqenin e Shkodrës paraqitet si më poshtë:

Tabela 5. Numri i individëve dhe i specieve të shpendëve ujorë dimërues në Liqenin e Shkodrës, International Waterbird Census

Viti i Censurit	2016	2019	2020	2021	2022
Numri i individëve	25,620	35,358	40,998	20,098	29,259
Numri i specieve	21	27	23	20	24

Për sa i përket numrit të individëve ndër vite, vihet re një rënie e konsiderueshme nga viti 2020 në vitin 2021, vite të cilat përkohë me periudhën më të vështirë të pandemisë së COVID-19. Në grafikun e mëposhtëm vërehet qartë reduktimi i numrit të shpendëve dimërues gjatë këtij harku kohor.




Figura 7. Numri i shpendëve dimërues të shpendëve ujorë dimërues në Liqenin e Shkodrës

Sot numërohen më shumë se 300 mijë individ numri i të cilëve është rritur ndjeshëm si rrjedhojë e miratimit të ligjit Nr. 7/2014 dhe Nr. 61/2016 “Për shpalljen e moratoriumit të gjuetisë në Republikën e Shqipërisë”. Lista e plotë e shpendëve gjendet në *Anex 2. të këtij botimi*.

Bimët: Pellgu i Liqenit përmban rreth 1900 lloje të bimëve, një pjesë e të cilave janë të përfshira në Listën e Kuqe të Florës Shqiptare.

Bimësia makrofite e Liqenit përfshin jo vetëm bimët të cilat rriten e zhvillohen në mjedisin e mirëfilltë ujor, por edhe të bimëve të cilat takohen në brigjet e liqenit. Një përfshirje e tillë në rastin konkret bëhet e nevojshme për faktin se luhatjet e nivelit të ujit shkaktojnë përmbytje të sipërfaqeve të tëra tokësore, duke bërë që për periudha të caktuara të vitit në mjedisin ujor të rriten edhe bimë të brigjeve të liqenit. Në disa raste, gjatë periudhës së ngrohtë në tokat dhe livadhet e lagështa e me ujë, edhe në ato jo fare pranë liqenit, por që mbushen me ujë gjatë dimrit, takohen bimë tipike ujore si lkoni i bardhë (*Nymphaea alba*) dhe lkoni i verdhë (*Nymphaea luteum*). Ndërmjet bimëve drunore disa janë të introduktuara.

Lista e bimëve sipas zonave vertikale bimore bazuar në studime të ndryshme është shumë e gjatë por vlen të citohet që bimësia në pellgun e liqenit të Shkodrës shtrihet në katër breza si më poshtë:



- i) **Zona e makjes** shtrihet në lartësinë **400-500 m** lartësi mbi nivelin e detit. Prej drurëve dhe shkurreve gjethembajtëse, më të përhapura të kësaj zone, janë: ilqja, dëllinja e kuqe, shqopa, ulliri, mareja, dafina etj. Prej drurëve dhe shkurreve gjetherënëse mund të veçojmë: shega, shkoza e zezë, murrizi një bërthamësh, manaferra, driza, krekëza, thanukla, vidhi i bardhë, amorfa shkurre, gjineshtra, frashër uji, frashëri i bardhë, plepi i bardhë, plepi i zi, shelgu i zi, shelgu i kuq, vërri i zi, fiku etj.
- ii) **Zona e dushkut** shtrihet në lartësitë **300-700 m** mbi nivelin e detit. Llojet më të përhapura të gjinisë *Quercus* të kësaj zone: bulgëri, qarri, shparthi, etj. Drurë dhe shkurre të tjerë të kësaj zone janë: panja rrapii, panja mali, panjë, gështenjë, vodhëviçëza, vodha, mëlleza, blini, lajthia, murrizi pesëbërthamësh, dëllinja e zezë etj.
- iii) **Zona e ahut** ndodhet në lartësitë **600-1700 m** mbi nivelin e detit dhe së bashku me nënzonën e pishës shkon deri 1900 m. Në këtë zonë gjenden lloje të drurëve si ahui, panja e malit, si dhe shkurret: borbulli i padhëmbëzuar, mjedra, boronica etj. Nga halorët më shumë gjenden: rrobulli, pisha e zezë e më pak të tjerat.
- iv) **Zona e kullotave alpine** shtrihet **1800-1900 m** mbi nivelin e detit. Disa gjini dhe lloje bimore më të përhapura të kësaj zone janë: trëndafil i egër, samina, shelgu zvarritës, flokësa, bishtpelëza, luluza italiane, këlerie, gentiana pranverore, lulekëmbana, klokëza etj.

Lumi Buna

Lumi Buna me gjatësi prej 44 km ka një prurje mesatare vjetore prej 320 m³/sek dhe së bashku me Lumin Drin bëjnë 680 m³/sek. Prurja maksimale e Bunës është 7500 m³/sek, duke bërë që Lumi Buna të njihet si i dyti në Pellgun e Adriatikut, pas lumit Po, dhe si i pesti në krejt Pellgun e Mesdheut, pas lumenjve Danubi, Nili, Rhine dhe Po (Qiriazi, 1986).

Përgjatë brigjeve të lumit Buna ka një biodiversitet me vlera të larta natyrore. Bimësia pyjore dikur ka qenë shumë më e pasur sesa sot. Një prej faktorëve kryesorë degradues ka qenë prerja e paligjshme e drurëve deri në kufijtë e një shpyllëzimi të plotë. Bimësi pyjore gjendet në njësitë administrative malore, brigjet e lumit në Rezervatin e Velipojës, Ishullin Ada, në fshatrat Reç, Sutjel, Shënkoll dhe në ishullin e Bahçallekut. Bimësia e sipërfaqeve pyjore të zonës së ulët përbëhet kryesisht nga disa lloje plepash (*Populus* spp.), shelgjesh (*Salix* spp.), frashëri (*Fraxinus* spp.), dushqesh (*Quercus* spp.) rrushkulli (*Ruscus aculeatus*), akacia (*Robinia pseudoacacia*), thana (*Cornus mas*), shkoza (*Carpinus betulus*), marina (*Tamarix parviflora*), etj.

Në lumin Buna gjenden mbi 30 lloje peshqish, që gjenden edhe në Liqenin e Shkodrës: në ujëra hasim shumë krapin (*Cyprinus carpio*), karasin (*Carassius auratus gibelio*), gjucën (*Alburnus alburnus alborella*), njilën (*Chondrostoma nasus ohridanus*), skortën e zezë (*Pachychilon pictum*), lloskën (*Scardinius erythrophthalmus scardafa*), mëlyshin (*Leuciscus cephalus albus*), sharmakun (*Perca fluviatilis*), barburinqin (*Blennius fluviatilis*), etj.

Lumi Buna është rrugë kalimi për 13 lloje e nënlloje peshqish të konstatuar që migrojnë nga liqeni për në detin Adriatik dhe anasjelltas. Ndër to përmendim blinin (*Acipenser sturio*) që është lloj globalisht i rrezikuar, kublën (*Alosa fallax nilotica*), ngjalën (*Anguilla anguilla*), levrekun (*Dicentrarchus labrax*), qefullin e verës (*Mugil cephalus*), qefullin e vjeshtës (*Liza ramada*), shojzën (*Platichthys flesus luscus*), etj.

Në hapësirën e grykëderdhjes së Bunës (Delta e Bunës) ka mbi 50 lloje të tjerë peshqish, ku ndër më të njohurit janë açuga (*Engraulis encrasicolus*), çeliku (*Aphanius fasciatus*), gjilpërëza turigjatë (*Syngnathus tenuirostris*), korbi i zi (*Sciaena umbra*), korbi i bardhë

(*Umbrina cirrosa*), sargu (*Diplodus sargus*), murra (*Lithognathus mormyrus*), aterina (*Atherina hepsetus*), gjuhëza e Adriatikut (*Solea vulgaris*), etj.



Fig. 7. Acipenser sturio, iNaturalist

Lumi Buna, së bashku me ujërat pranë saj, përfaqëson një nga korridoret më të rëndësishëm në Europë për migrimin e peshkut dhe shtegtimin e zogjve. Ai është baseni më i pasur në rajon sa i takon faunës. Grykëderdhja e Bunës, Rezervati i Velipojës, Këneta e Domnit, Laguna e Vilunit, Liqeni i Shasit, kriporja e Ulqinit, sipërfaqja kënetore e Shtojit të Poshtëm në Ulqin janë të populluara me shpendë, veçanërisht në dimër. Këto sipërfaqe përfshihen në një rreth prej tre rrugëve më të rëndësishme të migrimit të shpendëve të Evropës.

Në Bunë janë numëruar rreth 50 lloje shpendësh ujore. Ndër to kredharaku i vogël (*Tachybaptus ruficollis*), karabullaku i vogël (*Phalacrocorax pygmaeus*), kryekeqja e madhe (*Anas penelope*), rosa e vendit (*Anas platyrhynchos*), rosa sqeplugë (*Anas clypeata*), rosa kërre (*Anas crecca*), kryekuqja e mjeme (*Aythya ferina*), rosa me katër sy (*Bucephala clangula*), bajza (*Fulica atra*), cinja (*Vanellus vanellus*), pulëbardha e zakonshme (*Larus ridibundus*), etj. Rëndësi të veçantë ka pulëbardha e vogël (*Hydrocoloeus minutus*) dhe dallëndyshja e detit (*Sterna sandvicensis*), numri i të cilave konsiderohet i rëndësishëm ndaj numrit të përgjithshëm për Shqipërinë dhe Mesdheun. Veçohet gjithashtu kriporja e Ulqinit e cila aktualisht është një nga mjediset më të përshtatshëm për folezimin e shumë llojeve të cilat pastaj vijnë në Bunë edhe në pjesën shqiptare si laraska e detit (*Haematopus ostralegus*), gjelaci symadh (*Burhinus oedicnemus*), kalorësi (*Himantopus himantopus*), sqepbiza (*Recurvirostra avosetta*), bisht-dallëndyshja (*Glareola pratincola*), vrapuesi gushëbardhë (*Charadrius alexandrinus*), dallëndyshja e vogël e detit (*Sterna hirundo*), etj.

Parku Kombëtar “Alpet e Shqipërisë”

Parku Kombëtar “Alpet e Shqipërisë” përfshin Luginën e Valbonës, Lumin e Gashit dhe Thethin. Ky i fundit, pjesë e Bashkisë Shkodër, njihet për diversitetin e pasur të llojeve, faunes dhe florës. Në këtë zonë janë gjetur dhe jetojnë rreth 1500 lloje bimësh, të cilat përfaqësojnë gati gjysmën e florës së vendit tonë. Në listën e bimëve që jetojnë në këtë zonë rreth 100 lloje janë bimë mjekësore dhe tanifere shumë të dobishme për shëndetin e njeriut, ndërsa rreth 70 lloje janë të rrezikuara për zhdukje. Në Theth dallohen 3 kate bimore:

- i) Kati i dushkut, i cili ka bimësi shumë të larmishme dhe në të dallohen drurë si: qarri (*Quercus cerris*), mëlleza (*Ostrya carpinifolia*), shkoza (*Carpinus orientalis*), frashëri i bardhë (*Fraxinus ornus*), thana (*Cornus mas*), etj.
- ii) Kati i ahut ku bimët më të rëndësishme janë: ahu (*Fagus silvatica*), bredhi i bardhë (*Abies alba*), panja e malit (*Acer pseudoplatanus*), etj.
- iii) Kati i kullotave alpine që përbëhet nga bimë barishtore dhe pak shkurrëza si: dëllinjat (*Juniperus spp.*), shëlgjet (*Salix spp.*), etj. Ndër bimët më të rëndësishme të këtij kati janë: flokëzi (*Poa alpina*), pirësja e gjakut (*Sesleria nitida*), asteri (*Aster alpinus*), tërfili i alpeve



(*Trifolium alpestre*), thuepula (*Lotus corniculatus*) etj.

Fauna është e pasur dhe e larmishme. Aty gjejnë strehë dhe jetojnë rreth 20 lloje gjitarësh, 50 lloje shpendësh folenizues, afro 10 lloje zvarranikësh dhe rreth 8 lloje amfibësh. Lidhur me ekosistemet e pyjeve të lartë dhe me ato malore e alpine rëndësi



Fig. 8. Pamje nga Alpet e Shqipërisë.

Laguna e Vilunit

Laguna e Vilunit Shtrihet në segmentin më verior të bregdetit Adriatik, në atë Shëngjin - Grykëderdhja e Bunës. Me një gjatësi maksimale prej 3 km dhe gjerësia 0,9 km, kjo lagunë gjendet vetëm 7 km larg Deltës së Bunës, rreth 2 km larg vijës detare të plazhit të Velipojës dhe rreth 12 km larg plazhit të Shëngjinit. Sipërfaqja e saj është 1,96 km² por ajo ndryshon gjatë vitit, sidomos midis dimrit e verës. Thellësia luhartet nga 80-100 cm, por në disa segmente arrin 2 – 3 m. Formimi i Lagunës së Vilunit është i lidhur me evolucionin e gjithë Fushës së Velipojës. Hapësira nga grykëderdhja e Bunës e deri në perëndim të kurrizit kodrinor të Rencit, është formuar shekuj më parë. Në njërin nga këto pellgje me një formë pak a shumë të rregullt rrethore shënohet edhe Liqeni i Lundërzës. Formimi i kësaj lagune është rrjedhojë e një sërë faktorësh që po i rendisim si më poshtë:

- a) Veprimtaria akumuluese të dallgëve të detit;
- b) Materiali i bollshëm ranor që vinte nga prurjet e lumenjve të kësaj hapësirë, kryesisht Drini dhe Buna;
- c) Deluvionet e shpërndara nga shpatat e kurrizit të Rencit si dhe
- d) Mbushjet prej dekompozimeve bimore e shtazore.

Laguna e Vilunit karakterizohet nga bimësia barishtore e tokave të kripura. Në ujërat e kripura të Lagunës takohen potamogetoni (*Potamogeton nodosus*), potamogetoni si krëhër (*Potamogeton pectinatus*), gjethebriri i zhytur (*Ceratophyllum submersum*) etj. Kallamishtja (*Phragmites australis*), truska (*Pycreus flavescens*), etj janë gjithashtu një mjedis i preferuar për shpendët e ujit. Ndër bimët e tjera që hasen në lagunë janë këlkoja e ujit (*Alisma plantago-aquatica*), veronica barcapoi ujce (*Veronica anagallis-aquatica*), bliqini (*Butomus*

umbellatus), zhavari gjethegjërë (*Typha latifolia*), kulmaku bregdetar (*Juncus maritimus*), kulmaku i mprehtë (*Juncus acutus*), presja e larguar (*Carex distans*), heleoharëza majëhalëzuar (*Eleocharis acicularis*), laboti si shigjetë (*Atriplex hastata*), bargjaku i shelgjeve (*Lythrum salicaria*), fshesa (*Limonium vulgare*), krisja (*Cynodon dactylon*), halimionia si burdullak (*Halimione portulacoides*), zuba (*Holoschoenus vulgaris*), polipoga bregdetare (*Polypogon maritimus*). Ndërsa më në thellësi të lagunës zhvillohet një bimvsi tipike e shkurre e zonave të lagëta si dhe drurë. Llojet më të hasura janë mrina (*Tamarix parviflora*), plepi i bardhë (*Populus alba*), manaferra (*Rubus ulmifolius*), thanukla (*Cornus sanguinea*), vidhi (*Ulmus spp.*), trëndafili (*Rosa spp.*), murrizi (*Crataegus sp.*). Gjithashtu gjenden edhe bimë të katit të nënpyllit si salepi (*Orchis spp.*), fiershqiponja (*Pteridium aquilinum*), gjethedelli heshtor (*Plantago lanceolata*), gjethedelli i madh (*Plantago major*), briza e vogël (*Briza minor*), halmuca vezake (*Aegilops ovata*), bishtlepuri vezak (*Lagurus ovatus*), elbi (*Hordeum murinum*) etj. Në lindje të Lagunës shtrihet vargu kodrinor i Rrencit, përgjithësisht i zhveshur për shkak të terrenit shkëmbor dhe ndërhyrjeve të njerëzve. Por përsëri ai arrin të krijojë mikroklime me shumë vlerë. Në lagunën e Vilunit takohen shumë peshq carnivorë, erbovorë e omnivorë. Ndër peshqit më tipikë të cilët kanë rëndësi edhe për tregtinë mund të përmendim qefullin e verës (*Mugil cephalus*) dhe të vjeshtës (*Liza ramada*), por krahas tyre rriten edhe ngjala (*Anguilla anguilla*), levreku (*Dicentrarchus labrax*), gjuhëza (*Solea vulgaris*), barbuni (*Mullus barbatus*), lojba (*Lichia amia*) etj. Ndër shpendët takollen rreth 183 lloje në Lagunë, 193 në rezervatin e Velipojës si dhe rreth 144 lloje në Kënetën e Domnit. Laguna i ka kushtet shumë të përshtatshme për shpendët ujorë. Grupi më i përhapur është ai i harabelorëve ku mbizotërojnë stërqoka (*Corvus monedula*), cërloi I zi pikalosh (*Sturnus vulgaris*) dhe sorra (*Corvus corone cornix*). Në kënetën e Domnit gjendet më shpesh pula e ujit (*Gallinula chloropus*), gakti i vogël (*Ixobrychus minutus*), bajukla (*Fulica atra*) etj. Ndër shpendët të cilët janë rrëmbenjës veçohen shqipja e kënetës (*Circus aeruginosus*), ndërsa ndër shpendët ujorë jofolezues përmendim çikën e gardhit (*Acrocephalus arundinaceus*), çikën e kallamishteve (*Acrocephalus scirpaceus*). Disa lloje janë globalisht të rrezikuara: pelikani (*Pelecanus crispus*), kryekuqja e vogël (*Aythya nyroca*), shqiponja e madhe e rosave (*Aquila clanga*), skifteri kthetraverdhë (*Falco naumanni*) etj. Në pyllin pranë lagunës rriten edhe shumë lloje gjitarësh si dhelpra (*Vulpes vulpes*), lepuri (*Lepus capensis*), çakalli (*Canis aureus*), numri i të cilëve ka ardhur gjithnjë e në rënie. Disa lloje janë lloje që konsiderohen me rëndësi europiane si lundërza (*Lutra lutra*), kunadhja (*Martes foina*), ujku (*Canis lupus*) etj.

Pyjet dhe Kullotat nën administrimin e Bashkisë Shkodër

Ekosistemi i pyjeve dhe kullotat zënë një sipërfaqe të konsiderueshme në Bashkinë Shkodër. Këto ekosisteme mbartin në vetvete vlera ekonomike, mjedisore, ekologjike, ushqimore, rekreative e turistike. Sipërfaqet pyjore janë pjesë përbërëse e të gjithë territorit të Bashkisë Shkodër, por më të evidentuar në zonën malore, ku gjenden pyjet e lartë dhe me vlera të larta peisazhike.

Ekosistemet pyjore shërbejnë për prodhimin e lëndës së drurit dhe druve të zjarrit, punësimin banorëve në zonën rurale, ofrojnë shërbime mjedisore si: zbutjen e ndryshimeve klimatike, mbrojtjen e tokës nga erozioni dhe rrëshqitjet, reduktimin e dyoksidit të karbonit i cili pasi thithet nga pemët nëpërmjet fotosintezës depozitohet në dru, lëvore, gjethe e rrënjë. Sipërfaqet pyjore shërbejnë si rezervuar karboni, ndaj shtimi apo përmirësimi i këtyre sipërfaqeve do të ndihmonte në reduktimin e dioksidit të karbonit në atmosferë.

Në kuadër të protokollit të Kiotos ku bën pjesë edhe Shqipëria, shtetet janë dakortësuar të luftojnë efektin sere nëpërmjet uljes së sasisë së karbonit, përmes pyllëzimit dhe ripyllëzimit. Nëse ky objektivi arrihet, krijohen kapacitete të lira karboni (kredite karboni), të cilat mund të shiten tek vendet me teprica karboni.

Në administrim të Bashkisë Shkodër, me ndryshimin e VKM nr 433 dt 08.06.2016 “ Për



transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike , sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të MM e të ish komunave/bashkive” me VKM nr. 684 datë 02.09.2020 , kaloi fondi pyjor/kullosor me një sipërfaqe prej 48.656,71 ha fond ky i cili me daljen e VKM nr. 59 dhe 60 dt 22.01.2022 u zvogëluar me rreth 18000 ha dhe aktualisht Bashkia Shkodër administron një fond prej 30.666 ha.

Tabela 6. Sipërfaqet pyjore dhe kullosore, sipas listës së inventarit, të transferuara në pronësi të Bashkisë Shkodër

Asete	Sipërfaqe ha
Pyje	23,097.6 ha
Kullota	4,711.6 ha
Sipërfaqe inproduktive /shkembore	2,857.2 ha
Sipërfaqe bujqesore	2.5 ha
Sipërfaqe gjithsej:	30,668.8ha

Në sistemin natyror pyjet dhe kullotat zënë një sipërfaqe të konsiderueshme me vlera ekonomike, mjedisore, rekreative, turistike. Pyjet shpërndahen në të gjithë territorin e bashkisë, por veçanërisht në zonën malore, ku gjenden pyjet e lartë dhe me vlera të larta peizazhike.

Referuar vendimit të mësipërm , të dhënat e fondit pyjor/kullosor qe kanë kaluar në pronësi dhe administrim nga Bashkia Shkodër janë:

Bashkia Shkodër administron në territorin e saj një fond Pyjor/Kullosor prej **30,666 ha e ndarë si më poshtë:**

TABELA PERMBLEDHESE

Nr	Emertimi	SIP totale PYJE /ha	Sip pyje /ha	Bimesi pyore ha	sip kullote /ha	sip bujqesore/ha	sip HA Inproduktive /shkembore	SIP TOT HA
1	Ek Rosek Rrjoll	0.0	0.0	0.0	1329.3	0.0	0.0	1329.3
2	Ep Brucaj	2853.6	2853.6	0.0	140.1	0.0	192.9	3186.6
3	Ep Bushat Berdice	79.3	0.0	79.3	0.0	0.0	7.1	86.4
4	Ep Cukal	11.1	11.1	0.0	0.0	0.0	2.4	13.6
5	Ep Drin Gjader Kir	151.0	0.0	151.0	0.0	0.0	0.0	151.0
6	Ep Lugina e Kirit	7633.6	7633.6	0.0	770.1	0.0	1552.4	9956.0
7	Ep Pruemos Sheldi	1980.8	1945.2	35.6	1483.3	0.0	109.4	3573.5
8	Ep Rosek Drisht	6310.1	5464.5	845.6	13.9	0.0	499.8	6823.8
9	Ep Shllak 1	1010.0	1010.0	0.0	0.0	2.5	35.7	1045.7
10	Ep Shosh 1	3035.0	3035.0	0.0	442.1	0.0	457.5	3934.6
11	Ep Tarabosh	33.2	0.0	33.2	532.7	0.0	0.0	565.9
	Total	23097.6	21952.9	1144.7	4711.6	2.5	2857.2	30666.3

Në sipërfaqen pyjore dominojnë pyjet e larta bredhi dhe pisha, shkurre të ndryshme. Në kushtet e terrenit të pjerrët në zonën malore, pyjet janë faktori kryesor i mbrojtjes së tokës nga rrëshqitjet dhe erozioni, mbrojtjen e brigjeve të lumenjve dhe vijës bregdetare për mbrojtjen nga ndryshimet morfologjike dhe vijës bregdetare.

Tabela më poshtë jep të dhënat mbi llojet e pyllit, sipërfaqen dhe volumin e tij.

Nr.	Ekonomia Pyjore	Siperfaqja me pyje(ha)	Llojet Drunore	Volumi total(m3)	Vol.total l.punimi	Lpt, m3	Lpm, m3	Lph, m3	Dz, m3	Rv.totale m3/lloj	Mundesia vjet.e shfryt.D. zjarri
BASHKIA SHKODER, SIPERFAQJA TOTALE DHE VOLUMI SIPAS LLOJEVE PER FONDIN PYJOR PRODHUES		6441.90	Ah	1353865	1000320	282608	317169	400633	353455	19266	11560
		133.20	Pishe e Zeze	3745	2205	50	450	1705	1540	359	215
		705.90	Pishe Mesdhet.	12680	8470	1100	2410	4960	4210	2010	1206
		207.70	Halor Tjere	21887	15172	4907	5322	4843	6715	265	159
		0.00	Bredh	50	0	0	0	0	50	0	0
		3930.05	Dushqe	202446	52787	8146	16695	27946	149659	2030	1218
		2766.46	Geshtenje	136655	70708	39013	10114	11581	75947	3753	2252
		2474.20	Frasher	81489	1040	466.2	130	910	80449	1213	728
		193.70	Fletor tjere	12797	789	7	164	538	12088	75	45
		14.00	Panje	8135	3200	500	1150	1550	4935	15	9
		16.25	Bli	3250	1350	250	450	650	1900	1	1
		32.00	Arre	499	188	64	54	70	275	9	5
		3653.30	Shkurre te ndry.	136209	0	0	0	0	136209	5992	3595
	20568.66		1973707	1156229	337111	354108	455386	827432	34988	20993	
BASHKIA SHKODER, SIPERFAQJA TOTALE DHE VOLUMI SIPAS LLOJEVE PER FONDIN PYJOR MBROJTES		873.45	Ah	187490	122565	36190	39478	46897	64925	3314	1988
		0.00	Pishe e Zeze	150	120	0	0	120	30	11	7
		568.40	Pishe Mesdhet.	10279	7069	320	2100	4649	3210	1531	919
		31.50	Halor Tjere	16831	9126	2951	3085	3090	7705	39	23
		30.10	Bredh	17066	15530	9677	3368	2485	1536	17	10
		564.40	Dushqe	22872	3635	489.8	1127	2229	19137	222	133
		182.40	Geshtenje	18386	5522	100	2177	3245	12864	377	226
		188.55	Frasher	8112	4826.6	4442.6	4313	4481	7944	302	181
		144.40	Fletor tjere	2601	0	0	0	0	2601	17	10
		0.00	Panje	300	0	0	0	0	300	0	0
		165.25	Shkurre te ndry.	12611	0	0	0	0	12411	227	136
		2748.45		296698	168393.6	54170.4	55648	67196	132663	6057	3634
	TOTALI I FONDIT PYJOR(HA, M3)		23317.11		2270405	1324623	391282	409756	522582	960095	41045
A	PRODHUES	20568.66		1541346	911485	272138	264641	365162	639735	27862	16717
B	MBROJTES	2748.45		174402	107857.6	38467.4	36645	41366	70903	3992	3634

Biodiversiteti Urban

Nëse janë të mirë planifikuara, edhe hapësirat e vogla të gjelbra mund të sigurojnë shërbime me ndikim të madh në ekosistem, kur bëhet fjalë për kontekstin urban. Hapësirat e gjelbëruara sigurojnë benefite edhe për banorët e zonave urbane. Këto benefite ofrojnë rekreacion për qytetarët, eksperiencë me natyrën, ndikim pozitiv në mirëqenien mendore, hapësirë të shëndetshme për aktivitet fizik, rritje të cilësisë së mjedisit urban, ulje të temperaturave gjatë stinës së ngrohtë dhe ruajtje të nxehtësisë gjatë stinës së ftohtë, hijëzim, dhe rritje të vlerës së pronës. Bashkia Shkodër ka potencial të lartë llojesh bimore të cilat spikatin për vlerat e tyre të larta, të tilla si bimët relikte që rriten në mënyrë natyrale në lulishtet e qytetit dhe oborret e shtëpive shkodrane, të trashëguara ndër vite brez pas brezi.

Në të njëjtën kohë, llojet e introduktuara bimore janë të shumta, të konsideruara si një alternativë e mirë në rastet kur specie të ndryshme native nuk mund të mbijetojnë në zonat urbane. Kultura e kultivimit të bimësisë dekorative në qytetin e Shkodrës ka spikatur që herët e si rrjedhojë Shkodra është njohur për potencialin bimor të qytetit, që ka kontribuar në asetin natyral të tij.

Mbjellja dhe kujdesi ndaj bimëve dekorative dhe frutore përbën një traditë të trashëguar për Shkodrën. Zhvillimi natyral dhe i kultivuar i llojeve bimore është mundësuar dhe favorizuar falë kushteve të përshtatshme klimatiko-tokësore të qytetit. Në hapësirat e gjelbra publike përfshihen lulishtet e mëdha të qytetit para godinave kryesore në qendër, të cilat ofrojnë një pamje të bukur estetike dhe relaksuese, mitigojnë zhurmat dhe monotoninë, pastrojnë mjediset nga gazet e pluhurat duke e bërë mjedisin më të shëndetshëm, si dhe rrethrotullimet.

Lulishtet e qytetit të Shkodrës karakterizohen nga drurët të lartë gjethembajtës dhe gjetherënës me kurora të gjelbra, si dhe bimët e kultivuara për lulet shumëngjyrëshe. Disa lloje bimore



janë të përfshira në Librin e Kuq si bimë të rrezikuara, duke qënë se numri i tyre është pakësuar. Zgjedhja e bimëve për kultivim në zonat urbane, duhet të bëhet në përputhje me kushtet e zonës dhe me nivelet e burimeve natyrore në dispozicion. Gjithashtu duhet marrë në konsideratë një plan i mirëmunduar lidhur me efektet dhe benefitet që sjellin kultivime të tilla. Një histori suksesi e tillë është prezenca e bimës së blirit (*Tilia spp.*) në qendër të qytetit të Shkodrës, e cila përveç vlerave ekologjike dhe aromës së veçantë që lëshon gjatë lulëzimit ka edhe vlera mjekësore. Vlerat mjekësore të lules së blirit përfshijnë aftësinë për të përmirësuar sistemin imunitar, parandaluar disa lloje tumoresh, qetësuar organizmin, detoksifikuar atë, hequr ankthet, zvogëluar inflamacionin dhe ulur tensionin e gjakut.

Mjaft interesante dhe tërheqëse janë edhe oborret e familjeve shkodrane. Duhet theksojmë se familjet shkodrane i kanë kushtuar kujdes jo vetëm aspektit vizual të oborrit të tyre, por edhe kulturës së njohjes së llojeve bimore, rritjes dhe zhvillimit specifik të tyre duke rritur potencialin bimor natyror urban e njëkohësisht potencialin e diversitetit floristik, vlerat ekologjike dhe estetike, ku bëjnë pjesë llojet relikte dhe të introduktuara bimore.

Hapësirat e gjelbra ofrojnë relief vizual që përmirëson karakteristikat fizike të mjedisit si dhe luajnë funksione të rëndësishme ekologjike si rregullim të mikroklimës urbane, reduktim të stuhive, efekt të thithjes së karbonit, reduktim të ndotjes së ajrit dhe ujërave sipërfaqësorë, moderim të zhurmës, ruajtje të specieve etj. të cilat rrisin në total cilësinë e jetës në zonat urbane.

Hapësirat e gjelbra urbane ofrojnë përfitime për ekosistemet urbane që nga mirëmbajtja e biodiversitetit e deri tek rregullimi i klimës urbane. Ndryshe nga zonat rurale, në zonat urbane ndryshimet në rrezatimin diellor, rënien e shirave dhe temperaturës janë normale. Rrezatimi diellor, temperatura e ajrit, shpejtësia e erës dhe lagështia relative variojnë goxha në varësi të mjedisit të ndërtuar. Në zonat urbane, materialet e papërshkueshme të përdorura për rrugët dhe trotualet ruajnë nxehtësinë dhe bëjnë që shiu të mos absorbohet duke mbetur mbetet pezull mbi sipërfaqe. Gjatë periudhave të shirave të rëndë, uji akumulohet dhe kur tejkalohet kapaciteti i kullimit, ndodhin përmbytjet.

Ndryshe ndodh për zonat e gjelbërta. Sipërfaqet e gjelbëruara urbane janë në gjendje të ndërpresin dhe të ruajnë ujin, duke reduktuar kështu sasinë e ujit të shiut. Rezultati është më i mirë kur pemët mbillen në gropa të cilat përmbajnë dhëra të depërtueshme, të cilat mund të absorbojnë ujin shtesë. Uji gjithashtu largon edhe ndotësit nga sipërfaqja.

Ndryshimet klimatike janë shoqëruar nga përmbytje apo rënie të cilësisë së ujërave vitet e fundit. Sakaq ekzistenca e mjediseve të gjelbërta është ndihmuese në reduktimin e rrezikut të përmbytjes në zonat urbane. Ndaj dhe zgjerimi i sipërfaqeve të gjelbërta dhe rritja e diversitetit floristik në zonën urbane të bashkisë Shkodër përben një ndër objektivat e rëndësishëm të këtij plani.

Më poshtë janë prezantuar zonat e gjelbërta në qytetin e Shkodrës, lulishtet dhe oborret e familjeve shkodrane si më poshtë:

Tabela 7. Inventari i sipërfaqeve të lulishteve dhe rrethrotullimve

Nr.	Hapësira publike e gjelbër	Sipërfaqja (m ²)
1	Lulishta Xhabije (tek busti i Esat Gjyli)	900
2	Lulishta Xhabije (krahu I djathte)	571
3	Lulishta Perash (ish arka e kursimit)	1917
4	Lulishta blloqe banimi Dergut	249
5	Lulishta Perash (Sheshi Isa Buletini	4260
6	Lulishta Perash Rrethi	1425
7	Lulishta Perash para pallatit 5 kat	560
8	Lulishta Perash para pallatit 5 kat krahu majte	165
9	Lulishta te rruga 13 Dhjetori (pas pallatit 5 kat ish pasticeri Rinia)	1242
10	Lulishta Bashkia (lulishta e re ne ndertim)	750
11	Lulishta Parruc (Shatervani)	9015
12	Lulishta Gjumnazi 28 Nentori	3235
13	Rreth rrotullimi Rruga Bulevardi Skenderbeu	134
14	Lulishta "Pashko Vasa"(shkolla N. Mazi)	970
15	Sheshi Demokracia	742
16	Lulishta Blloqe banimi Xhabije	6215
17	Lulishta Blloqe banimi Bahcja Cakej	1160
18	Lulishta te Teater" Migjeni "	2626
19	Parku "Luigj Gurakuqi "	5436
20	Lulishta te busti "L.Gurakuqi	215
21	Lulishta Telekom (te Nane Tereza)	372
22	Lulishta shtepia Muze "Oso Kuka "	1000
23	Lulishta tek Hotel " Rozafa "	453
24	Lulishta te monumenti "Prek Cali "	50
25	Lulishta Tepe (te blloku I banesave)	800
26	Lulishta Zona Industriale	1850
27	Lulishta Zona Industriale 2	930
28	Lulishta Vatra Pazar	7408
29	Lulishta Nr. 2 Pazar	6343
30	Pedonalia Ura e Bunes	2650
31	Lulishta ish Pasticeri Rinia	240
32	Lulishta te blloku i pallateve rruga Faik Konica	467
33	Lulishta blloku i pallateve Ara Pashes	230
34	Lulishta te biblioteka e Universitetit	150
35	Rreth rrotullimi te Bulevardi Mehmet Pashe Plaku	314
36	Rreth rrotullimi te stadiumi	610
37	Rreth rrotullimi Parruce	346
	Siperfaqja totale (m²)	66 000






Figura 9. Harta e organizimit të hapësirës publike. Burimi Plan i Përgjithshëm VENDOR për Planifikimin e territorit të Bashkisë Shkodër

II. ZONAT E MBROJTURA, LLOJET, PRONËSIA DHE FORMAT E QEVERISJES

Zonat e Mbrojtura, sistemi kombëtar i kategorizimit dhe qeverisjes

Zonë e mbrojtur quhet një pjesë tokësore apo ujore, me vlera të veçanta për mbrojtjen e biodiversitetit, të burimeve natyrore e kulturore të lidhura me të, për shfrytëzimin e së cilës përdoren rrugë ligjore dhe masa efektive.

Zonat e mbrojtura sipas llojit të interesit për të cilin ka marrë statusin e mbrojtjes janë:

- a) **Zona të Mbrojtura me interes kombëtar;**
- b) **Zona të Mbrojtura me interes ndërkombëtar ku bëjnë pjesë:**
- c) Zonat Ramsar;
- d) Zonat me interes për Komunitetin Europian (SACs) ku bëjnë pjesë zonat e veçanta të ruajtjes të habitateve dhe të shpendëve (SCI dhe SPAs);
- e) Zonat me Interes të Veçantë Ruajtjeje (zonat Emerald)
- f) Zonat Rezervë të Biosferës.
- g) Zonat e Trashëgimisë Natyrore dhe Kulturore të UNESCO-s

Qëllimi kryesor i shpalljes së zonave të mbrojtur është “*dhënia e të drejtës për mbrojtje*”. Kjo do të thotë që pasuritë e këtyre zonave të përdoren në mënyrë të kontrolluar, përmes parimit të shfrytëzimit të qëndrueshëm pa shkakuar dëmtimin e pasurive natyrore, dhe biodiversitetit që ato mbartin.

Zonat e mbrojtura në territorin e Republikës së Shqipërisë janë pasuri kombëtare. Pronësia mbi zonat e mbrojtura është: (i) shtetërore, (ii) private. Kurse forma e qeverisjes mbi zonat e mbrojtura është (i) shtetërore, (ii) private, (iii) bashkiake, (iv) të kombinuara.




Fig.10. Harta e zonave të mbrojtura para vitit 2022




Fig.11. Harta e zonave të mbrojtura para vitit 2022



Forma e qeverisjes për çdo zonë konkrete përcaktohet në vendimet e Këshillit të Ministrave që miraton krijimin e zonës, ndryshimin e statusit apo ndryshimin e sipërfaqes së saj. Propozimi i formës së qeverisjes që propozohet për miratim, duhet bërë pasi të jetë marrë mendimi i komunitetit të zonës, i pronarëve privatë dhe miratimi me shkrim i bashkisë përkatëse ku shtrihet zona. Në mbështetje të vlerave natyrore dhe përdorimit të qëndrueshëm të tyre, sistemi kombëtar i ZM, i mbështetur në Direktivën 31992L0043 “Për konservimin e habitateve natyrore dhe të florës e faunës së egër” dhe Direktivën 32009L0147 “Mbi mbrojtjen e shpendëve” ka përcaktuar disa kategori të zonave të mbrojtura si më poshtë:

- a) Rezervë strikte natyrore/rezervat shkencor (**Kategoria I**);
- b) Park kombëtar (**Kategoria II**);
- c) Monument natyror (**Kategoria III**);
- d) Rezervat natyror i menaxhuar/park natyror (**Kategoria IV**);
- e) Peizazh i mbrojtur (**Kategoria V**);
- f) Zonë e mbrojtur e burimeve të menaxhuara (**Kategoria VI**);
- g) Park natyror bashkiak (**Kategoria IV**);
- h) Kurorë e gjelbër (**Kategoria V**).

Rezervë strikte natyrore (Kategoria I): Rezervë strikte natyrore shpallen territore ose zona relativisht të vogla, që zotërojnë disa ekosisteme të veçantë, karakteristike ose përfaqësuese, dhe/ose lloje të florës dhe/ose të faunës me rëndësi shkencore, të përshtatshme për kërkime shkencore dhe/ose monitorim, dhe që janë pak ose aspak të shqetësuara nga njeriu. Kjo kategori përbëhet nga dy nënkategori kryesore: a) **Nën/Kategoria Ia** - Zonë e Mbrojtur e menaxhuar kryesisht për qëllime shkencore ose Rezervati Shkencor, e cila ruhet dhe menaxhohet për qëllime shkencore dhe mbrojtjen tërësore të botës së gjallë; b) **Nën/Kategoria Ib** Zonë e Mbrojtur e menaxhuar kryesisht për mbrojtjen e natyrës së egër ose Rezervë Strikte Natyrore, që ruhet e menaxhohet në mënyrë të atillë që të ruajnë gjendjen e tyre natyrore. **Në rezervën strikte natyrore zbatohet niveli më i lartë i mbrojtjes, pasi në të janë të ndaluara të gjitha aktivitetet njerëzore dhe ku objektivat kryesorë janë:**

- i) ruajtja e biodiversitetit të zonës duhet të jetë e arritshme nëpërmjet mbrojtjes dhe të mos kërkojë menaxhim aktiv ose manipulim të habitateve;
- ii) të minimizohen çrregullimet dhe shqetësimet nëpërmjet planifikimit të kujdesshëm të realizimit të kërkimit shkencor dhe të aktiviteteve të tjera të miratuara;
- iii) të kufizohen kontaktet e publikut me zonën dhe të përjashtohet përdorimi i saj për pushim e çlodhje;
- iv) të lejohet prania e vizitoreve pa mjete të motorizuara në atë nivel që t’i shërbejë sa më mirë mirëqenies fizike dhe shpirtërore të tyre dhe të ruaj cilësinë e natyrës së egër të zonës për brezat e sotëm dhe të ardhshëm.

Park kombëtar (Kategoria II): Park kombëtar shpallen territoret e gjera, zakonisht jo më të vogla se 1,000 ha, unike për nga vlerat kombëtare dhe ndërkombëtare, që ruhen dhe menaxhohen për mbrojtjen e ekosistemeve, llojeve, edukim dhe rekreacion (çlodhje,

argëtim), që përjashton shfrytëzimin ose zënien me aktivitete intensive nga ana e njeriut.

Monument natyror (Kategoria III): Monument natyror shpallet formacioni natyror (përfshirë edhe elemente të veçanta biologjike) formacioni i veçantë gjeologjik dhe gjeomorfologjik, një depozitë minerale ose një habitat i një lloji të rrallë e të kërcënuar ose me rëndësi e vlerë të veçantë shkencore dhe estetike. Zona mbrohet e menaxhohet për ruajtjen e karakteristikave dhe dukurive të veçanta natyrore, kulturore, historike e arkeologjike, për të cilat është shpallur monument. Për vizitat ose kalimin e vizitorëve a te turistëve, ministri harton rregulla te veçanta, për afate të shkurtra kohore.

Rezervat natyror i menaxhuar ose Park Natyror (Kategoria IV): Përfaqësojnë zona me ndërhyrje aktive te njeriut për qëllime menaxhimi të llojeve dhe habitateve, në mënyrë që të garantohet ruajtja e habitateve dhe te plotësohen kërkesat specifike të llojeve me rëndësi rajonale e vendore, si dhe zonat që përdoren për qëllime studimore, edukative dhe kulturore.

Peizazh i mbrojtur (Kategoria V): Peizazh i mbrojtur shpallen territore të mëdha, me peizazh harmonik e të formuar mirë, me relief të zhvilluar karakteristik, me

larmi ekosistemesh, detare ose tokësore, sipërfaqet brenda të cilave mund te ketë edhe qendra banimi qe zhvillojnë aktivitete si bujqësia, pemëtaria, pylltaria, peshkim. Kjo kategori përfshin toka/det/ujë në pronësi publike ose private. Veprimtaritë dhe aktivitetet në këto zona kanë objekt kryesorë:

- i) të fuqizohet ndërveprimi harmonik i natyrës me kulturën për mbrojtjen e cilësisë të peizazhit, përdorimit tradicional të tokës, praktikave ndërtimore dhe manifestimeve sociale e kulturore karakteristike të zonës;
- ii) të mbështesë ato mënyra jetese dhe aktivitete ekonomike që janë në harmoni me natyrën dhe ruajtjen e konstitucionit shpirtëror dhe kulturor të popullsisë lokale;
- iii) të kufizojë përdorimin e tokës dhe kryerjen e aktiviteteve që janë të papërshtatshme në përmasa dhe/ose përmbajtje;
- iv) të krijojë mundësi për kënaqësi të publikut përmes çlodhjes dhe turizmit, në përputhje me karakterin dhe përmasat e karakteristikave thelbësore të zonës;
- v) të inkurajojë aktivitete shkencore dhe edukative, të cilat ndihmojnë në zhvillimin dhe mirëqenien për një kohë të gjatë të popullsisë lokale dhe në sigurimin e mbështetjes së gjërë publike për mbrojtjen e mjedisit të zonave të mbrojtura të tilla;
- vi) të sjell përfitime ekonomike dhe të kontribuojë në rritjen e mirëqenies së popullsisë lokale përmes shfrytëzimit të produkteve natyrore, si pyje dhe prodhimi i peshkut dhe shërbimeve, si uji i pastër ose të ardhura që vijnë nga format e përshtatshme të turizmit;
- vii) të lejojë ndërhyrjet e lejuara urbane, rekreacioni apo ekonomike brenda zonës, duke ruajtur karakterin e zonës sipas parashikimeve të këtij ligji dhe VKM-së së shpalljes së zonës së mbrojtur.

Zonë e mbrojtur e burimeve të menaxhuara (**Kategoria VI**): Zona të mbrojtura të burimeve të menaxhuara shpallen territore që përfshijnë territore të gjëra, relativisht, të izoluar dhe të pabanuara, ose pak të populluara, të cilat mund të jenë nën presion të vazhdueshëm për t'u populluar dhe përdorur më gjerësisht. Në këto zona shkalla e mbrojtjes ka si objekt kryesor:

- i) **të mbrojtë** dhe ruajë diversitetin biologjik dhe vlera të tjera të zonës për një kohë të gjatë;



- ii) **të kontribuojë** në zhvillimin rajonal dhe kombëtar;
- iii) **të nxisë** praktika mbarështuese për qëllime të prodhimit të qëndrueshëm;
- iv) **të mbrojë resurset gjenetike** ose sisteme dru frutoresh me karakteristika natyrore;
- v) **të mbrojë burimet natyrore** bazë nga përdorimet për qëllime të tjera të tokës që mund të jenë dëmtoese për diversitetin biologjik të zonës.

Parqet Natyrore Bashkiake (Kategoria IV): Parku Natyror Bashkiak shpallet me vendim të Këshillit Bashkiak, në kuptim të zonës së mbrojtur, një sipërfaqe brenda territorit administrativ të një ose më shumë bashkive, pas dhënies së miratimit paraprak që bëhet nga ministri përgjegjës për zonat e mbrojtura. Parqet Bashkiake sigurojnë përdorim të qëndrueshëm të territorit dhe zhvillimin e veprimtarive, që i përshtaten karakterit të zonës dhe që lidhen ekskluzivisht me nevojat e komunitetit. Miratimi i kritereve dhe procedurave të shpalljes së parqeve natyrore bashkiake bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave me propozim të Ministrit.

Planet e menaxhimit të Parqeve Bashkiake miratohen me urdhër të kryetarit të bashkisë.

Kurorë e gjelbër (Kategoria V): Kurora e gjelbër shpallet me vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit, në kuptim të zonës së mbrojtur pyjore, një sipërfaqe brenda territorit administrativ të bashkisë me qëllim mbrojtjen e kurorave të gjelbra të çdo bashkie në Republikën e Shqipërisë dhe është detyrim për çdo bashki. Ajo siguron përdorim të qëndrueshëm të territorit dhe zhvillim të veprimtarive, që i përshtaten karakterit të zonës dhe që lidhen ekskluzivisht me nevojat e komunitetit. Miratimi i kritereve dhe procedurave të shpalljes së “Kurorës së gjelbër” dhe përcaktimi i rregullave dhe i përgjegjësive në lidhje me administrimin, mbrojtjen dhe ruajtjen e kurorës bëhen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit që mbulon mjedisin. Planet e menaxhimit të “Kurorës së gjelbër” miratohen me urdhër të ministrit dhe i dërgohen për zbatim bashkive.

Mbështetur në sistemin kombëtar të zonave të mbrojtura, në territorin e Bashkisë Shkodër janë klasifikuar zona të mbrojtura në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar ekosistemet e prezantuara në tabelën më poshtë.

Tabela 9. Zonat e Mbrojtura në Bashkinë Shkodër					
Nr	Emërtimi	Kategoria	Vendimi	Sipërfaqe (ha)	Sip. ZM ne B.SH. (ha)
1	Alpet e Shqipërisë	Park Kombëtar IUCN II	VKM nr.59, datë 26.1.2022	82,844.65	14,722.51
2	Liqeni i Shkodrës	Rezervat Natyror i Menaxhuar IUCN IV	VKM nr.60, datë 26.1.2022	24,049.75 <i>ishite 26,535</i>	6,481.13
3	Lugina e Shalës	Park natyror IUCN IV	Vendim nr.60, datë 26.1.2022	10,619.35	10,404.97
4	Lumi Buna & Laguna e Vilunit	Peizazh ujor/tokësor i mbrojtur IUCN V	VKM nr.682, datë 2.11.2005	23,027.00	18,392.96
5	Liqeni Shkodrës & Lumi i Bunës	Zona RAMSAR	VKM nr.683, datë 2.11.2005	49,562	

Zonat e mbrojtura në Bashkinë Shkodër zënë një sipërfaqe prej **49,196.14** ha ose 51 % të sipërfaqes së përgjithshme të territorit të bashkisë (pa zonat RAMSAR).




Fig 12. Harta e zonave të mbrojtura ne territorin e Bashkisë Shkodër

Statusi i ZM në Bashkinë Shkodër. Aktivitete të lejuara dhe të ndaluara sipas ligjit

2.1.1 Parku Kombëtar “Alpet e Shqipërisë”


Vendimi nr. 59, datë 26.1.2022 solli miratimin e ndryshimit të statusit dhe të sipërfaqes së ekosistemeve natyrore “Lugina e Valbonës” dhe “Theth”, shpallur “park kombëtar” (kategoria II e zonave të mbrojtura) dhe “Lumi i Gashit”, shpallur “rezervë strikte natyrore” (kategoria I e zonave të mbrojtura), në park kombëtar “Alpet e Shqipërisë” (kategoria II e zonave të mbrojtura), me një sipërfaqe prej 82,844.65 ha në total. Funkcionet menaxhuese të Parkut Kombëtar “Alpet e Shqipërisë”, kryhen nga Administratat e Zonave të Mbrojtura, Qarku Shkodër dhe Kukës.

Zona brenda këtij ekosistemi natyror përfshin pyje, kullota, toka bujqësore, shkurre, sipërfaqe ujore, inproduktive dhe zona urbane. Mbulesa e tokës brenda sipërfaqes së Parkut Kombëtar, jepet në Tabelën x, si më poshtë:



Tabela x. Sipërfaqja e Parkut Kombëtar, e përshkruar sipas mbulesës.

Mbulesa	Sip. në ha	Përqindja
Pyje	34496.15	41.6
Sipërfaqe heterogjene bujqësore	2474.87	2.9
Sipërfaqe me vegjetacion të pakët	15704.22	18.9
Kullota	400.82	0.48
Shkurre	29491.88	35.59
Zona Urbane	276.71	0.33
Total	82844.65	100



Parku Kombëtar “Alpet e Shqipërisë” ndahet në tre nënzona ruajtjeje e administrimi, si më poshtë vijon:

a) **Nënzona Qëndrore A**, me sipërfaqe 1,695.1 ha, e shënuar në hartë me ZQ A.

Kjo nënzona përfshin habitatet kryesore pyjore (pyje të lartë, cungishte dhe shkurre) dhe përcaktohet si zonë me vlera të larta për trashëgiminë natyrore e biodiversitetin dhe në të zbatohet shkalla më e lartë e mbrojtjes, që siguron një territor të pashqetësuar. Në këtë nënzona **lejohen** kërkimi shkencor, zhvillimi i veprimtarive ekoturistike të kontrolluara në natyrë. Në ZQ A janë **të ndaluara**: prerja e drurëve dhe e shkurreve; përdorimi i kimikateve dhe i plehrave kimike; ndërtime të çdo lloji; nxjerrja e mineraleve dhe e torfave; ndezja e zjarreve; kullotja, kalimi i kafshëve shtëpiake dhe ndërtimi i objekteve për mbajtjen e tyre; etj.

b) **Nënzona Qëndrore B**, me sipërfaqe 54,180.07 ha, e shënuar në hartë me ZQ B.

Kjo nënzona përfshin habitatet kryesore pyjore (pyje të lartë, cungishte dhe shkurre) dhe përcaktohet si zonë me vlera të larta për trashëgiminë natyrore e biodiversitetin dhe në të zbatohet shkalla më e lartë e mbrojtjes, që siguron një territor të pashqetësuar. Në këtë nënzona **lejohen** kërkimi shkencor, zhvillimi i veprimtarive ekoturistike të lira në natyrë. Në ZQ B janë **të ndaluara**: shfrytëzimi i tokës me teknologji intensive, me mjete dhe mënyra që shkaktojnë ndryshime rrënjësore në biodiversitet, në strukturën dhe funksionet e ekosistemeve ose që dëmtojnë në mënyrë të pandreqshme në sipërfaqen e tokës;

neutralizimi i mbetjeve me origjinë jashtë territorit të “Parkut Kombëtar”; shpërndarja e kafshëve dhe e bimëve jovendase, kur ato sjellin ndryshime në biodiversitetin e sonës; riprodhimi intensiv, me përjashtim të riprodhimeve shpëtuese; ndërtimi i rrugëve, autostradave, hekurudhave, zonave urbane, hidrocentraleve, linjave të tensionit të lartë dhe sistemeve të naftës dhe gazit me shtrirje të gjatë; larja dhe spërkatja e rrugëve me kimikate; mbjellja e pyjeve monokulturë; etj.

c) **Nënzona e Përdorimit Tradicional dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm**, me sipërfaqe 26,969.48 ha, e shënuar në hartë me ZPTQ.

Kjo nënzonë përfshin tokat bujqësore e kullotat, dhe territore ujore ku **mundësohet** vazhdimi i veprimtarive tradicionale si bujqësi, kullotje, grumbullimi i bimëve mjekësore e aromatike, me përdorim të balancuar të tyre dhe **nuk lejohen** ndërtimet e veprimtaritë që shkaktojnë ndryshimin e gjendjes natyrore të ekosistemit. Në nënzonën e përdorimit tradicional dhe zhvillimit të qëndrueshëm, zbatohet shkalla e dytë e mbrojtjes, që siguron një territor me ndikim të ulët dhe kontroll të veprimtarive ekonomike, sociale, agrobiznesit, argëtuese, sportive e ekoturistike, ndërtimi i infrastrukturës sipas planeve të zhvillimit urban e turistik të miratuar nga Këshilli Kombëtar i Territorit (KKT), të cilat nuk çënojnë integritetin ekologjik të ekosistemit dhe respektojnë funksionet e zonës së mbrojtur, vlerat ekologjike dhe ato të peizazhit natyror e kulturor.




Figura 13. Harta e zonimit të Parkut Kombëtar “Alpet e Shqipërisë”. ZQ A= Nënzona Qëndrore A, ZQ B= Nënzona Qëndrore B, ZTPQ= Nënzona e Përdorimit Tradicional dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm.



Thethi me peisazhin e tij madhështor, ka karakteristikë përroin e kristaltë të Thethit, ku rritet *trofta e mermertë* dhe kataraktin e Grunasit me rreth 30 metra lartësi që i japin vlera specifike natyrore dhe ekonomike. Parku i Thethit është habitat i rëndësishëm për jetën e faunës së egër dhe përbën zonën më të populluar në Shqipëri **me riqebullin**, i cili është specie e pakësuar.

Thethi është kompleks, me larmi habitatesh dhe tipe **vegetacioni**, ku pjesën më të madhe e zënë ato të pyjeve të ahut (*Fagus sylvatica*), por ka dhe formacione shkurre me mbizotërim të boronicës (*Vaccinium myrtillus*) apo kullota alpine (*Poion alpinae*), të cilat bashkëshoqërohen dhe me shkurre xhuxhe dhe të zonave alpine si: (*Juniperus communis*; *Juniperus nana*; *Juniperus sibirica*.), driada tetëpetalshe (*Drias octopetala*), etj. Në këtë zonë gjejnë strehë dhe jetojnë rreth 1500 lloje bimësh, të cilat përfaqësojnë gati gjysmën e llojeve të florës së vendit tonë. Për t'u vlerësuar janë prania e drurit relikto të tisisit (*Taxus baccata*), brenda katit drunor të pyllit të ahut, megjithëse në ekzemplarë të rrallë, si dhe bimët endemike (*Wulfenia baldacci*; *Viola dukadjinica*; *Lilium albanicum*.), dhe bimët subendemike *Aquilegia dinarica* dhe *Teucrium arduin*). Në Theth gjendet edhe Gentiana *Gentiana Lutea*) e vetmja specie endemike në botë me emrin e mbretit Ilir Genti.



Fig 14. *Lilium albanicum*, iNaturalist



Fig 15. *Taxus baccata*, pixabay

Fauna e Thethit wshtw gjithashtu e pasur dhe e larmishme. Ka rreth 20 lloje gjitarësh, 50 lloje shpendësh folezues, afro 10 lloje zvarranikësh dhe rreth 8 lloje amfibësh. Rëndësi paraqesin gjitarët dhe shpendët e lidhur me pyjet e larta dhe ekosistemet malore e alpine. Ndër gjitarët më të mëdhej të parkut janë: ariu i murrmë (*Ursus arctos*), ujku (*Canis lupus*), Rreqebulli (*Lynx lynx*), dhia e egër (*Rubicapra rubicapra*), kaprolli (*Capreolus capreolus*), etj. Në pyllin e lartë, nga shpendët mbizotërojnë kryesisht pjesëtarët e familjes së *Fragillidae* (4 lloje), dhe *Paridae* (4 lloje). Përbërës të tjerë më të rrallë janë elementë tipik të pyllit të lartë si: qukapikët (3 lloje), zvarritësi i drurëve (*Sitta europea*), etj. Në katin e shkurreve hasim lloje të tjera si: gushkuqi (*Erithacus rubecula*), mëllenja (*Turdus merula*), larashi kurrizkuq (*Lanus collurio*), etj. Gjendja e përgjithshme e habitateve është relativisht e mirë.



Fig 16. *Lynx lynx*, AKZM

2.1.2 Liqeni i Shkodrës

Liqeni i Shkodrës është ekosistem ujor ndërkufitar. Ndodhet në kufirin shqiptaro-malazez, midis malit të Taraboshit, Fushës së Mbishkodrës, Fushës së Podgoricës dhe qytetit të Shkodrës. Me VKM nr.684 date 02.11.2005 pjesa shqiptare e Liqenit të Shkodrës me sipërfaqe 11944 ha shpallet “Rezervat natyror i menaxhuar”. Vendimi nr.60, datë 22.1.2022, miratoi ndryshimin e sipërfaqes së ekosistemit natyror/ligatinor “Liqeni i Shkodrës”, shpallur “rezervat natyror i menaxhuar” (kategoria IV e zonave të mbrojtura), **nga 26,535 ha në 24,049.75 ha.**

Zona e mbrojtur në pjesën shqiptare ka këto kategori mbrojtjeje:

- i) **Zona qendrore e përbërë nga:** bregu i liqenit, që fillon nga pika ekstreme perëndimore e fshatit Zogaj deri në kufirin Shqipëri – Mal i Zi, shpati i Malit Tarabosh nga lartësia 494 m në jug, deri në 200 m në brendësi të ujërave të liqenit në segmentin ndërkufitar Zogaj-Shqipëri-Mal i Zi në veri. **Në këtë zonë aplikohet niveli i II i mbrojtjes**
- ii) **Zonë e habitateve të menaxhuara** e përbërë nga: gjithë sipërfaqja ujore e liqenit, përjashtuar zona e përfshirë në 1/a e përmendur më sipër; bregu perëndimor shqiptar nga ura e Bunës në lindje, në fshatin Zogaj në perëndim (duke rrethuar zonën 1/a të kësaj pike) duke përfshirë gjithë lartësitë e këtij segmenti deri në 300 m në shpatin e Malit Tarabosh në jug. **Në këtë zonë aplikohet niveli III i mbrojtjes**
- iii) **Zonë e zhvillimit tradicional** e përbërë nga: e gjithë sipërfaqja lindore e liqenit, kufizuar në perëndim me zonën 2/a të përmendur më sipër, deri në rrugën Shkodër-Hani i Hotit në lindje dhe qytetin e Shkodrës në fundin juglindor. **Në këtë zonë aplikohet niveli i IV i mbrojtjes.**

Liqeni i Shkodrës i shpallur Rezervat Natyror i Menaxhuar dhe Zone RAMSAR bën pjesë në kompleksin ujor “Liqeni i Shkodrës-Drini-Buna” dhe përfaqëson një nga sistemet hidrografike më të komplikuar dhe më interesante në Ballkan. Është liqeni më i madh në Gadishullin e Ballkanit, për sa i përket sipërfaqes ujore. Liqeni i Shkodrës përfshihet në pellgun ujëmbledhës të detit Adriatik. Pasqyra ujore e tij ka një sipërfaqe prej 368 km nga të cilat 149 km² përfshihen brenda territorit shtetëror të Shqipërisë, ndërsa pjesa tjetër ndodhet në Malin e Zi. Ai shtrihet në kufirin midis vendit tonë dhe Malit të Zi, në pjesën jugore të Alpeve në veri, në jug (hyrja e Bunës) dhe në lindje (ana e qytetit të Shkodrës). Liqeni i Shkodrës lidhet me Detin Adriatik nëpërmjet emisarit të vetëm të tij, Lumit Buna.






Fig. 17. Harta e Zonimit të Zonës së Mbrojtur të Liqenit të Shkodrës.




Figura 18. Harta e Zonimit të Zonës së Mbrojtur të Liqenit të Shkodrës (Pjese e territorit të Bashkisë Shkodër)

Sipas sistemit kombëtar të mbrojtjes në zonat e kategorisë së IV ku futet edhe Liqeni i Shkodrës janë të ndaluara veprimtaritë që kanë si objekt kryesor:

- **ndalimin e ndryshimit** të gjendjes natyrore të rezervave ujore, burimeve, liqeneve dhe sistemeve të zonave të lagura;
- **sigurimin dhe ruajtjen** e kushteve të habitatit të domosdoshme për mbrojtjen e llojeve të rëndësishëm, grup-llojeve, komuniteteve biotike ose karakteristikave fizike të mjedisit, që kërkon ndërhyrje të veçantë për një menaxhim optimal;
- **lehtësimin e kërkimit shkencor** dhe monitorimit mjedisor si aktivitete parësore të lidhura me menaxhimin e qëndrueshëm të resurseve natyrore;
- **ngritjen e zonave të kufizuara për edukimin mjedisor** të publikut, vlerësimin e karakteristikave të habitateve dhe të punës për menaxhimin e llojeve në natyrë;
- **eliminimin, parandalimin e shfrytëzimit** dhe zënien e zonës me aktivitete që bien ndesh me qëllimet për të cilat ajo është marrë në mbrojtje;
- **t'i japë mundësi popullsisë** lokale të përfshirë brenda zonës të sigurojnë përfitime ekonomike si një nga objektivat e menaxhimit.

2.1.3 Lumi Buna dhe territoret ligatinore përreth tij

Lumi i Bunës, së bashku me Deltën dhe rezervatin e Velipojës, luginën e Vilunit, plazhin e Baks-Rrjollit, kënetën e Domnit, si dhe territoret përreth tyre janë shpallur **“Peisazh ujor/tokësor i mbrojtur” me VKM nr. 683 datë 2.11.2005**. Ky peisazh ujor/tokësor i mbrojtur kufizohet në veri me vijën që bashkon daljen e Lumit Buna nga Liqeni i Shkodrës deri në kufirin verior me Republikën e Malit të Zi; në perëndim kufizohet me vijën e kufirit shtetëror përgjatë lumit Buna me Republikën Mali i Zi; në lindje kufizohet

me vijën që bashkon daljen e lumit Buna nga liqeni i Shkodrës deri te Rana e Hedhun dhe në jug kufizohet me vijën bregdetare nga rëra e hedhur deri tek grykëderdhja e lumit Buna. Lumi Buna ka një sipërfaqe të përgjithshme 23027 ha, të përbërë nga këto sipërfaqe si në tabelën 9.

Tabela 9. Lumi Buna dhe territoret ligatinore – Sipërfaqet në ha

Lumi Buna dhe territoret ligatinore	Sipërfaqe (ha)	Perqindja
Sipërfaqe pyjore dhe shkurre	7799 ha	33.9
Sipërfaqe lagunore	346 ha	1.6
Duna ranore, bregdetare	496 ha	2.1
Toka të kripura	252 ha	1
Sipërfaqe të tjera (toka bujqësore, zona të banuara)	14134 ha	61.4
Sipërfaqe e përgjithshme	23027 ha	100

Sipas kategorisë së mbrojtjes ky ekosistem ndahet në disa zona apo nën kategori si më poshtë:

Zona qendrore (A.1) përbëhet nga: Pjesa e lumit Buna dhe brigjet e tij nga bashkimi me lumin Drin deri në fshatin Obot; Brigjet e lumit Buna në pjesën perëndimore të rezervatit të Velipojës, nga grykëderdhja e lumit deri përballë skajit verior të ishullit Ada dhe 200 m në brendësi të rezervatit në lindje; Ishulli i Franc Jozefit dhe bregdeti në lindje të grykëderdhjes, në gjatësi deri 2 km dhe gjerësi 300 m në det, drejt jugut (aktualisht ishulli është zhdukur - **Ky është rasti tipik i humbjes së habitateve si pasojë e erozionit bregdetar.**

Pjesa qendrore dhe veriore e lagunës së Vilunit; Gadishulli në plazhin e Baks-Rrjollit dhe një gjerësi 300 m në jug të vijës bregdetare deri te rëra e hedhur; Pjesa qendrore e kënetave të Domnit dhe të Murtemzës. Lumi Buna, shkakton në mënyrë të vazhdueshme përmbytjen e tokave të Nën-Shkodrës, si rrjedhojë e shumë faktorëve. Në këtë kontekst, nevojiten të zbatohen një grup masash komplekse për të parandaluar këtë fenomen me ndikime të ndjeshme ekonomike, sociale e mjedisore.

Zona qendrore (A.2) e përbërë nga: pjesa e lumit Buna në një gjatësi brigjesh 3 km në anën e djathtë të lumit, në veri të fshatit Oblikë; pjesa e lumit nga fshati Obot (e kufizuar në veri me pjesën e përmendur në pikën (A.1) deri në pikën përballë skajit verior të ishullit Ada (e kufizuar në jug me pjesën e përmendur në pikën A.1), me një gjerësi 200 m drejt lindjes; gjithë sipërfaqja e rezervatit të Velipojës, me përjashtim të asaj të përfshirë në pikën A.1 më sipër; pjesa jugore e lagunës së Vilunit (e mbështetur nga pjesa e përfshirë në pikën A.1) dhe gjithë sipërfaqja kënetore, që rrethon brigjet e lagunës; zona e Baks-Rrjollit, e mbetur nga pjesa e përfshirë në pikën A.1 deri në lartësinë 335 m në shpatin e malit Kolaj, në veri; pjesa e kënetave të Domnit dhe të Murtezës, që rrethon atë të të përmendur në pikën A.1. Në këtë zonë zbatohet shkalla e dytë e mbrojtjes “Për zonat e mbrojtura”.

Zonë qendrore (A.3) e përbërë nga: pjesa e lumit Buna, me gjatësi brigjesh 2 km, midis fshatrave Shirq dhe Obot, në anën e djathtë të lumit; në gjatësi si brigjesh 2 km të lumit Buna, në veri të fshatit Dajç, në anën e majtë të lumit. Në këtë zonë zbatohet shkalla e tretë e mbrojtjes “Për zonat e mbrojtura”.

Zona e zhvillimit tradicional (zona B). Zona e zhvillimit tradicional (B1) është e përbërë nga: fushat e Velipojës, me sipërfaqe 2500 ha; fushat e Pentarit, me sipërfaqe 850 ha; pellgjet

(ish- vaskat e peshkut) e fshatit Reç, me sipërfaqe 114 ha dhe kullotat e Urës së GjoLulit dhe Domnit, me sipërfaqe 2200 ha. Në këtë zone zbatohet shkalla e katërt e mbrojtjes “Për zonat e mbrojtura”, ku mund të ushtrohen veprimtari me karakter rikrijues, edukativ, ekoturistik, si dhe përdorimi tradicional i tokës, në harmoni të plotë me ruajtjen e natyrës dhe të vlerave shoqërore e kulturore të komunitetit vendas.

Zonë e zhvillimit tradicional (B2) është e përbërë nga territori i fshatit Pentar, në kufirin me Malin e Zi, vazhdon përmes kënetave të lumit Buna e kodrave të Rrencit dhe zbret në bregdet te Rëra e hedhur, e cilësuar si korridor migrimi. Në këtë zone zbatohet shkalla e dytë e mbrojtjes “Për zonat e mbrojtura”.

Zonë e tranzicionit (zona C). Zona e tranzicionit (C1) përbëhet nga plazhi i Velipojës, i kufizuar në perëndim nga rezervati i Velipojës, në veri nga rruga automobilistike dhe me shtrirje, në lindje, deri në 500 m përpara kanalit të komunikimit të lagunës së Vilunit me detin. Në këtë zone zbatohet shkalla e katërt “Për zonat e mbrojtura”. Në këtë zone mund të ushtrohen veprimtari bujqësore, si dhe mund të përdoren toka për qëllime të ndryshme turistike, sportive, edukative, rikrijuese etj., që nuk cenojnë natyrën dhe biodiversitetin, mbështetur në zhvillimin e qëndrueshëm dhe menaxhimin e burimeve natyrore të zonës.




Fig 19.Harta ekzistuese e zonave të mbrojtura “Lumi Buna-Velipoje”







Fig. 20. Harta e propozuar e zonimit të zonës së Mbrojtur "Lumi Buna –Velipojë"

2.1.4 Lugina e Shalës

E shpallur Park Natyror i kategorisë IV, me Vendim nr.60, datë 26.1.2022, Lugina e Shalës përfshin sipërfaqe me pyje, sipërfaqe heterogjene bujqësore, shkurre, inproduktive dhe sipërfaqe ujore.

Tabela 10. Sipërfaqja e PN-së, e përshkruar sipas mbulesës

Mbulesa	Sip. në ha	Përqindja
Pyje	4474.7	42.14
Sipërfaqe heterogjene bujqësore	1445.1	13.61
Sipërfaqe ujore	22.1	0.21
Sipërfaqe pa/ose me vegjetacion të pakët	848.9	7.99
Urbane	165.45	1.56
Shkurre & Bimësi barishtore	3663.1	34.49
Total	10619.35	100



Parku Natyror “Lugina e Shalës” ndahet në dy nënzona ruajtje e administrimi, si më poshtë vijon:

a) **Nënzona Qëndrore**, me sipërfaqe 3046.49 (tre mijë e dyzetë e gjashtë presje dyzetë e nëntë) ha, e shënuar në hartë me ZQ.

Kjo nënzona përfshin habitatet kryesore pyjore, shkurre dhe përcaktohet si zonë me vlera të larta e të rralla për trashëgiminë natyrore e biodiversitetin dhe në të zbatohet shkalla më e lartë e mbrojtjes, që siguron një territor të pasqetësuar. Në këtë nënzona lejohen kërkimi shkencor, zhvillimi i veprimtarive ekoturistike të lira në natyrë.

b) **Nënzona e Përdorimit Tradicional dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm**, me sipërfaqe 7572.86 (shtatë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e dy presje tetëdhjetë e gjashtë) ha, e shënuar në hartë me ZPTQ.

Kjo nënzona përfshin tokat pyjore, bujqësore e kullotat, dhe territore ujore, ku mundësohet vazhdimi i veprimtarive tradicionale si punime për shëndetësimin e pyjeve, aktivitete bujqësore, kullotja, grumbullimi dhe kultivimi i bimëve mjekësore e aromatike, me përdorim të balancuar të tyre dhe nuk lejohen ndërtimet e veprimtaritë ekonomike që shkaktojnë ndryshimin e gjendjes natyrore të ekosistemit natyror. Në nënzona e përdorimit tradicional dhe zhvillimit të qëndrueshëm, zbatohet shkalla e dytë e mbrojtjes, që siguron një territor me ndikim të ulët dhe kontroll të veprimtarive ekonomike, sociale, agrobiznesit, argëtuese, sportive e ekoturistike, ndërtimi i infrastrukturës sipas planeve të zhvillimit urban e turistik të miratuar nga Këshilli Kombëtar i Territorit (KKT), të cilat nuk çënojnë integritetin ekologjik të ekosistemit natyror dhe respektojnë funksionet e zonës së mbrojtur, vlerat ekologjike dhe ato të peizazhit natyror e kulturor.






Fig. 21. Harta e zonimit të Parkut Natyror "Lugina e Shalës". ZQ= Nënzona Qëndrore, ZPTQ= Nënzona e Përdorimit Tradicional dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm.

III. INDENTIFIKIMI I FAKTORËVE TË DEGRADIMIT DHE KËRCËNIMIT TË HABITATEVE DHE HUMBJES SË BIODIVERSITETIT

3.1. Identifikimi i Faktorëve Degradues

Në territorin e Bashkisë, flora dhe fauna janë të kërcënuara për shkak të keqpërdorimit, mbishfrytëzimit si dhe menaxhimit jo të mirë të këtyre burimeve me vlera të mëdha ekonomike, mjedisore dhe sociale. Si rrjedhojë e përdorimit intensiv të burimeve natyrore për qëllime të përfitimit ekonomik, këto probleme janë bërë shumë të dukshme dhe të shpeshta në dekadat e fundit. Ndër vite, habitatet natyrore dhe diversiteti i tyre kanë qënë nën presionin e lëvizjeve demografike të popullsisë (migrimit të brendshëm) në zona të pasura me vlera natyrore duke sjellë si pasojë ndryshimin e peizazheve, denatyrimit e baseneve lumore, brigjeve liqenore, etj. Për më tepër, niveli i ulët i edukimit mjedisor të popullsisë ka qënë dhe mbetet tregues i shfrytëzimit intensiv të biodiversitetit, duke përfshirë këtu ekosistemet pyjore, lumore, liqenore e detare.

Nga analiza e vazhdueshme e situatës mjedisore dhe ndjekja e zhvillimeve të viteve të fundit konstatohet se kemi të bëjmë me disa faktorë kërcënues të biodiversitetit në territorin e bashkisë Shkodër.

1. Fragmentimi i konsiderueshëm i ekosistemeve ujore si Liqeni i Shkodrës, Lumi Buna, Laguna e Vilunit, etj. dhe humbja e habitateve për lloje të veçanta dhe të rëndësishme të florës e faunës;
2. Humbje direkte të habitateve shkaktuar nga përmbytjet e vazhdueshme të viteve të fundit si dhe nga erozioni i tokave;
3. Zhdukja e disa llojeve të peshqve, bimëve dhe shpendëve nga mbishfrytëzimi dhe përdorimi i mekanizmave jo ligjorë në zonat me burime të pasura natyrore;
4. Rënia e numrit të llojeve si dhe fragmentimi i habitateve të brigjeve në Liqenin e Shkodrës;
5. Rritja e shkallës së eutrofikimit të ujërave të Liqenit dhe përshpejtimi i shkallës së kënetëzimit të tij;
6. Rreziku që paraqet erozioni në brigjet e lumit Buna në humbjen e sipërfaqeve të tokës dhe pyjeve, si dhe në humbje të trashëgimisë kulturore;
7. Mbishfrytëzimi i brigjeve të lumenjve për marrje inertesh kryesisht zhavorr, duke shkaktuar denatyrim të shtretërve;
8. Përkeqësimi i cilësisë së ujërave dhe peizazheve si pasojë e urbanizimit dhe shtimit të ndotjes nga mbetjet urbane në zonën e bregut të liqenit, brigjeve të Bunës dhe bregdetit (zona e mbrojtur e rezervatit Velipojë dhe Delta e Bunës);
9. Pakësimi dhe zhdukja e disa llojeve bimore e shtazore me shumë interes ekonomik sidomos në burimet peshkore në zonën e Lagunës së Vilunit;
10. Dëmtimi i sipërfaqes pyjore dhe degradimi i habitateve natyrore rreth lagunës së Vilunit, si dëmtimi i kallamishteve;
11. Mbishfrytëzimi i shumë llojeve të egra të bimëve aromatiko-mjekësore dhe atyre me interes ekonomik përfshirë këtu *sherbela*, *shqopa*, *trumëza*, *çaji i malit*, etj. duke sjellë si pasojë zhveshjen e mbulesës bimore të zonave natyrore. Është e rëndësishme të theksohet



se cilësia e varieteteve të egra të bimëve të lartpërmendura nuk mund të krahasohet me cilësinë e bimëve që kultivohen nga fermerët;

12. Pyjet në zonën e Thethit janë dëmtuar, e për pasojë fauna e këtyre pyjeve ka pësuar humbje të mëdha në shumë popullata të llojeve me rëndësi për biodiversitetin kombëtar dhe global;
13. Cënimi i shumë territoreve dhe llojeve nga zhvillimi i aktiviteteve të paligjshme në territorin e zonave të mbrojtura, pavarësisht nga fakti se janë nën mbrojtjen e legjislacionit kombëtar e konventave ndërkombëtare të adoptuara nga Kuvendi i Shqipërisë;
14. Lëvizjet demografike të popullsisë në brigjet e Liqenit të Shkodrës, të Lumit Buna dhe Lagunës së Vilunit, kanë sjellë degradim të habitateve dikur krejtësisht natyrore;
15. Urbanizimi, ndërtimi i banesave, fermave, plantacioneve, kopshtarive, vendbanimeve njerëzore, si dhe shpyllëzimet, kullotjet, depozitimet e mbetjeve si derivatë të urbanizimit ndikojnë në fragmentimin e habitateve të gjallesave, qoftë të vegjetacionit apo të kafshëve.

Praktikat e kaluara dhe/apo të sotme të zhvillimit kanë sjellë pasoja shpesh të pakthyeshme për rajonin pasi zinxhiri i jetës biologjike është i lidhur me sigurimin e cilësisë së jetës biologjike të ekosistemeve. Si rrjedhojë e këtyre praktikave në zonat e mbrojtura të Bashkisë Shkodër janë evidente: *humbja dhe fragmentimi i habitateve me rëndësi për riprodhimin e ushqimin e shumë llojeve; dëmtimi, varfërimi, dhe degradimi i ekosistemeve dhe habitateve; shqetësimi kafshëve të egra në natyrë si dhe zhdukje llojesh apo kërcënim për zhdukje i disa prej tyre; zvogëlimi i densitetit të mbulesës bimore për lloje të bimëve me interes mjekësor dhe ekonomik si dhe erozion gjenetik.*

Thelbin e biodiversitetit e përbëjnë llojet, habitatet dhe ekosistemet, ndaj dhe mbrojtja e tyre duhet të favorizojë llojet më të kërcënuara si dhe ato me rëndësi kombëtare dhe ndërkombëtare. Në këtë këndvështrim, rëndësi të veçantë në menaxhimin e një zone me vlera natyrore është menaxhimi i zgjuar i biodiversitetit dhe konkretisht për:

- i) Llojet dhe habitatet e kërcënuara në mënyrë kritike me rëndësi globale, rajonale e kombëtare si Liqeni i Shkodrës dhe kompleksi ligatinor Lumi Buna - Laguna e Vilunit
- ii) Habitate dhe ekosisteme që shquhen për endemizëm apo biodiversitet të lartë si Parku kombëtar i Thethit;
- iii) Habitate ose lloje në rrezik zhdukje të pakthyeshme si ishulli i Franc Jozefit apo lloje të gjallesave si blini (*Acipenser sturio*), rreqebulli (*Lynx Lynx*), tisi (*Taxus baccata*) etj.
- iv) Habitate ose lloje, ruajtja dhe menaxhimi i përshtatshëm i të cilëve do të rezultonte me përfitime ekonomike dhe edukative lokale apo kombëtare, zona përreth Liqenit dhe Bunës, Laguna e Vilunit etj.

3.2 Identifikimi i sfidave të menaxhimit të pyjeve dhe kullotave në Bashkinë Shkodër.

Me zbatimin e reformës së re administrative territoriale, pyjet dhe kullotat janë asete të transferuara në pronësi të bashkive. Me VKM nr. 684 datë 02.09.2020 , kaloi fondi pyjor/kullor me një sipërfaqe prej 48.656,71 ha fond ky i cili me daljen e VKM nr 59 dhe 60 dt 22.01.2022 u zvogëlua me rreth 18000 ha dhe aktualisht Bashkia Shkodër administron një fond prej 30.666 ha. Sipërfaqet

e konsiderueshme pyjore të Bashkisë Shkodër , shtrihen në zona me vlera të larta natyrore si në brigjet e lumenjve Drin, Buna, Kir dhe Shalë si dhe në zonat malore të kësaj njësie vendore.

E parë në këndvështrimin e aseteve bashkia Shkodër ka një potencial të lartë biologjik, ekonomik, turistik, natyror, alternativ dhe ekologjik i cili është në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të ekonomisë lokale dhe alternativave të punësimit për banorët. Në të njëjtën kohë, menaxhimi i këtyre aseteve është një sfidë më vete për Bashkinë Shkodër pasi qasja e këtij menaxhimi ka të bëjë me ngritjen e strukturave të posaçme administrative, rritjen e kapaciteteve vendore për administrimin e aseteve, hartimin e strategjive vendore dhe planeve të veprimit të cilat shoqërohen me kosto të konsiderueshme financiare. Në të njëjtën kohë gjendja aktuale e menaxhimit të pyjeve në bashkinë Shkodër ka një sërë problemesh si më poshtë vijon:

- 1 Mungesa e planeve të menaxhimit të fondit pyjor për territorin e ri administrativ të Bashkisë Shkodër;
- 2 Gjendje e dëmtuar e këtij fondi nga prerjet e paligjshme, kryesisht për dru zjarri;
- 3 Dëmtim të veshjes pyjore të brigjeve të lumenjve, Drin, Bunë e Kir;
- 4 Dëmtim të bimësisë së katit të nënpyllit në zonat pyjore; mungesa e mbjelljeve të reja në zonat e zhveshura; humbja e strehës së qëndrimit të kafshëve dhe shpendëve, reduktimi i polenizimit të bimëve nga prerja e paligjshme e pyjeve, etj.;
- 5 Erozion i tokave bujqësore në brigjet e lumenjve në ato zona e segmente pa veshje pyjore;
- 6 Mungesë e punimeve përmirësuese në kullotat të cilat shtrihen kryesisht në luginën e Kirit, Shalës, Maja e Pejës, Shosh deri në lartësitë më të mëdha. Mbrojtja nga erozioni i kullotave kërkon disa punime shtesë, me qëllim që të garantohet kapaciteti maksimal kullosor.

3.3. Identifikimi i Faktor Kërcënues të Biodiversitetit në Territorin e Bashkisë Shkodër

Krahas faktorëve degradues, **larmia biologjike përballet edhe me faktorë kërcënues** të cilët duhet të njihen dhe konsiderohen për shfrytëzimin e zgjuar të resurseve natyrore në territorin e bashkisë Shkodër. Faktorët kërcënues përbëjnë shkallën më të lartë të riskut për të cilën autoritetet vendore duhet të planifikojnë aktivitete në terma afatgjatë për të siguruar të ardhmen e qëndrueshme biologjike të rajonit. Ndër faktorët kërcënues të identifikuar janë:

- i) **Shkarkimi i ujërave të pa trajtura në ekosistemet ujore Liqeni i Shkodrës, Lumi Buna apo Lumi Drin është një ndër faktorët prioritarë që kërcënon** eutrofikimin në Liqenin e Shkodrës. Nga Raportet periodike të Gjëndjes në Mjedis të publikuara çdo vit nga AKM, është arrirë në përfundimin se nisur nga vlerat e transparencës, të nevojës kimike për oksigjen dhe nevojës biokimike për oksigjen rezulton se ujërat e Liqenit të Shkodrës janë të cilësisë mezotrofike. Në raportin e vitit 2022, theksohet se nuk duhet të shkaktohet ndotje nga aktivitete të ndryshme si peshkimi, turizmi pasi mund të ndikojë në rritjen e mezotrofisë. Tashmë, ndotjet e përqëndruara të ujërave të zeza janë faktor kërcënues dhe problem mjedisor shumë të mprehtë. Duke qenë se shkaku kryesor i eutrofikimit dhe ndotjes së ujërave mbetet derdhja e ujërave të zeza të patrajtuara, ndërtimi i impiantit të ujërave të zeza merr një prioritet të veçantë në listën e të gjithë aksioneve që planifikohen të ndërmerren nga Bashkia e Shkodrës në kuadër të këtij plani.



- ii) **Mbetjet e ngurta të ndërtimeve kryesisht përgjatë bregut të Lumit Kir vlerësohen ndotje kritike** duke krijuar vatra informale depozitimesh që kërkojnë ndërhyrje të vazhdueshme për heqjen dhe largimin e tyre. Depozitimi i mbetjeve të ngurta të ndërtimeve është kërcënim për të ardhmen e qëndrueshme të ekosistemeve ujore pasi ato shkaktojnë ndotjen, cektimin si dhe prishjen e habitateve të shumë gjallesave e për rrjedhojë diversitetin e jetës biologjike. Identifikimi, studimi dhe miratimi i një vend depozitimi për mbetjet e ndërtimit / mbetjet inerte mbetet prioritet madhor për bashkinë Shkodër.
- iii) **Gjuetia e peshkut dhe kafshëve të rralla:** Në ekosistemet ujore Liqeni i Shkodrës, Lumit Buna, Delta Bunës, Laguna e Vilunit si dhe zonave të tjera natyrore me vlera brenda territorit të bashkisë së Shkodrës është ushtruar gjueti intensive e peshkut, e kafshëve dhe e shpendëve. Pas viteve 90-të për më shumë se dy dekada, **gjuetia e peshkut është zhvilluar jashtë kontrollit dhe me mjete te paligjeshme**, duke shkaktuar dëme të pa kthyeshme për resurset peshkore të ekosistemeve të ujërave të ëmbla. Ende sot, gjuetia e peshkut mbetet sfidë pasi nuk janë sporadike rastet e peshkimit me mjete të ndaluara dhe në periudha të riprodhimit të peshkut, etj. Kjo qasje ka bërë që struktura e popullatave të peshkut të ndryshojë drejt popullatave jo të dëshiruara dhe jo me interes ekonomik si resurs pershkor.
- Po kështu, **gjuetia e kafshëve** që është një nga aktivitetet me ndikim të madh në gjendjen e biodiversitetit llojor **është zhvilluar jashtë kufinjve të ligjshmërisë**. Kjo ka sjellë rënie të numrit të individëve në popullatat e llojeve të egra, objekt gjuetie dhe sidomos shpendëve, pjesa më e madhe e të cilëve kanë pësuar rënie. Gjuetia e shpendëve, shpesh jashtë kriterit, është ndër faktorët që ka çuar në uljen e efektivëve të popullatave dhe zvogëlimin e numrit të atyre që folezojnë në brigjet e Lumit Buna dhe të Liqenit të Shkodrës. Situata është përmirësuar pas vitit 2014 me vendosjen dhe zbatimin e Moratoriumit të Gjuetisë së Kafshëve e Shpendëve të egra.
- iv) **Marrja dhe nxjerrja prej habitateve e llojeve të rralla e të kërcënuara.** Ky fenomen konsiderohet si **një nga faktorët më kërcënues të biodiversitetit gjenetik**. Lloje të ndryshme të gjallesave janë gjuajtur pa kriter, me mjete shfarosëse të jashtëligjshme dhe popullatat e tyre kanë ulur ndjeshëm numrin e individëve. Kjo ka bërë që ato të konsiderohen lloje të kërcënuara apo në rrezik zhdukjeje. Kjo dukuri nuk ka munguar në zonat natyrore të bashkisë së Shkodrës me gjithë tendencën në ulje gjatë viteve të fundit.
- v) **Prerjet e drurëve dhe dëmtimet e bimëve të nënpyllit:** Prerjet e drurëve në sipërfaqet me pyje bregut të liqenit, prerja e kallamishtes, frysës dhe zhavarit, dëmtimi i sipërfaqeve bimore nën ujë dhe ato notuese, kanë sjellë shkatërrime në shoqërimet bimore e sidomos në rrezikimin e zhdukjes së llojeve bimore, por edhe kërcënimin për zhdukje të shumë llojeve shtazore të cilat jetojnë dhe riprodhohen aty. Të shfrytëzuara nga aktiviteti i njeriut sidomos për ngrohje, prodhime kashte, mobiljesh ato shpesh janë keqpërdorur duke rënë pre e mizorisë së njerit dhe kjo ka çuar në degradim sipërfaqesh të tëra, erozion toke dhe humbje të llojeve të katit të nënpyllit me interes kryesisht mjekësor, pra ekonomik. Jo më pak kërcënuese janë zjarret e përvitëshme në pyje që kërcënojnë jetën biologjike.
- vi) **Ndryshimet e regjimit uJOR basenit të Drinit dhe pellgut të tij ujëmbledhës:** Qysh kur Drini filloi të derdhet në Bunë, Liqeni i Shkodrës ka pësuar regjim hidrologjik të shqetësuar. Kur prurjet e janë të mëdha, liqeni gati e dyfishon sipërfaqen e vet, sepse

pengohet edhe derdhja e tij në lumin Bunë. Mbushja e lumit Buna ka sjellë reduktimin e llojeve migratore për në det. Të dy lumenjt Drin dhe Bunë kanë brigje të dëmtuar për shkak të erozionit, nxjerrjes së inerteve si dhe ndërtimeve të pa kontrolluara. Rreziqet që kanosen sot prej erozionit kanë detyruar banorët që të mbjellin përsëri drurë pyjorë ose të kujdesen për lastarët e rinj të dalë nga trungjet e prera. Sot mund të llogaritet një sipërfaqe pyjore prej rreth 20 ha me moshë relativisht të re, e cila gjendet përgjatë këtyre lumenjve. Megjithatë ende duhet treguar kujdes për mbathjen e tokave e pengimin e erozionit të brigjeve.

- vii) **Introduktimi i llojeve të reja ne basen:** Në Liqenin e Shkodrës gati 1/3 e llojeve të peshqve janë auoktone. Gati gjysma e këtyre llojeve është injektuar nga njeriu para disa dekadash. Këto janë lloje ekzotike, të cilët riprodhohen në mënyrë artificiale. Të gjitha këto zhvillime, kanë lënë pasojë në popullatat e llojeve të tjera autoktone të peshqve të liqenit. Shumë lloje peshqish autoktonë tani janë zhdukur ose janë në rrezik zhdukje. Introduktimi i llojeve të reja në Liqenin e Shkodrës si lloje jo me shumë interes ekonomik ka sjellë edhe humbjet në popullatat autoktone dhe në ekuilibrat gjenetikë të tyre.
- viii) **Lëndët ndotëse:** Lëndët ndotëse janë faktorë me ndikim të madh në cilësinë e jetës biologjike dhe shëndetit të njeriut. Këto lëndë kalojnë në trupin e gjallesave përmes ciklit të transferimit të lëndës dhe bëhen shkak intoksimin e njeriut gjatë përdorimit të tyre si ushqim. Ndotjet më të mëdha të ujërave sipërfaqësore të pellgut të Liqenit, vijnë kryesisht nga shkarkimet e ujërave të zeza të papërpunuara në bashkinë Shkodër, si dhe nga shkarkimet e ujërave të papërpunuar të **Fabrikës së Aluminit** në Malin e Zi. Lëndët kimike bujqësore, e sidomos pesticidet, të cilët aktualisht përdoren në pellgun e Liqenit, infiltrojnë në liqen dhe shkaktojnë gjithashtu ndotje të ujërave. Mbetjet komunale, janë faktor eutrofizues dhe me pasojë të mëdha në shëndetin e njeriut, për shkak të përmbajtjes së patogjenëve dhe detergjentëve në to.
- ix) **Ndryshimet klimatike** janë faktor kërcënues në nivel global por natyrisht edhe në nivel lokal për larminë biologjike. Në fushën e ndryshimeve klimatike, Shqipëria ka ratifikuar Konventën e Vjenës dhe Protokollin e Montrealit, në Tetor 1999, si dhe është anëtare e Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara mbi Ndryshimet Klimatike (UNFCCC). Parlamenti Shqiptar ratifikoi Marrëveshjen e Parisit nëpërmjet Ligjit nr. 75, datë 14.07.2016 “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Parisit”. Në këtë kontekst, autoritetet vendore luajn rol shumë të rëndësishëm në parandalimin e kërcënimeve ndaj ndryshimeve klimatike.

Nisur nga vlerësimi i faktorëve degradues dhe kërcënues për biodiversitetin e Bashkisë Shkodër grupi i punës u ndal edhe në një analizë vlersësuese SWOT që e kemi prezantuar në tabelën më poshtë:



Tabela 11. Analiza SWOT për biodiversitetin. Bashkia Shkodër

Pikat e forta	Pikat e dobëta
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Shkodra është e pasur me ekosisteme natyrore; ▪ Territori në zotërim të Bashkisë ka biodiversitet të lartë llojor si dhe diversitet ekosistemesh; ▪ Autoritetet lokale e kombëtare që punojnë në drejtim të ruajtjes së biodiversitetit kanë potenciale njerëzore për menaxhim; ▪ Në zonat me vlera natyrore janë zbatuar dhe vazhdojnë të zbatohen programe me në fokus ruajtjen e biodiversitetit; ▪ Në Bashkinë e Shkodrës ka institucion akademik (Universiteti “Luigj Gurakuqi”) dhe shkallë të lartë profesionalizmi për çështjet e biodiversitetit.; ▪ Ekziston një bazë ligjore për ruajtjen e mjedisit dhe të biodiversitetit; ▪ Bashkia Shkodër ka Drejtorinë e Mjedisit dhe Energjise së Rinovueshme që punon për ruajtjen dhe mbrojtjen e diversitetit biologjik në territorin e saj administrativ; ▪ Sistemi hidrologjik unikal i Shkodrës ndihmon ruajtjen e diversitetit biologjik ujor. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Ndotja mikrobiologjike e ekostemeve ujore është prezente si pasojë e shkarkimeve të pakontrolluara të ujrave te zeza; ▪ Ekosistemi ujore Liqeni i Shkodrës po përballen me eutrofikimin dhe ka tendencë në rritje; ▪ Vazhdon prerja e pyjeve dhe dëmtimet e florës dhe faunës në ekosistemet tokësore; ▪ Ende nuk është ndaluar plotësisht peshkimi dhe gjuetia e jashtëligjshme; ▪ Mungesë e fondeve të konsiderueshme për biodiversitetin; ▪ Ka mungesa të theksuara në zbatimin e ligjeve; ▪ Mungesë në shkëmbimin e informacionit mes aktorëve; ▪ Ka mungesë të punës në terren; ▪ Mungesë të sistemit të monitorimit të parametrave biologjikë, kimikë e toksikologjikë si dhe publikimin e të dhënave; ▪ Ka mungesë të besueshmërisë për saktësinë e të dhënave;
Mundësitë	Kërcënimet
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Pozita e favorshme gjeografike në rajon dhe diversitet i lartë i ekosistemeve natyrore; ▪ Ka potenciale për zhvillimin e ekoturizmit, agroturizmit dhe bujqësisë organike; ▪ Ka sensibilizim të komunitetit për shërbimin e ekosistemeve; ▪ Ka prani të donatorëve dhe fondeve për ruajtjen dhe menaxhimin e biodiversitetit; ▪ Ka potencial dhe ekspertizë lokale për çështjet e biodiversitetit pasi kërkuesit e rinj shkencor të Universitetit Luigj Gurakuqi mund të angazhohen dhe impenjohen në këtë fushë; ▪ Ekzistojnë programe dhe strategji për zhvillimin e rajonit të Shkodrës; ▪ Ka zona të mbrojtura me status kombëtar dhe ndërkombëtar që rrisin mundësitë e financimeve në zonë dhe tërheqin donatorët; 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Mungesa e fondeve dhe donatorëve potencial për prioritetet që kërcënojnë biodiversitetin; ▪ Mungesa e transparencës në vendimmarrjet mjedisore; ▪ Mos zbatimi i saktë i legjislacionit mjedisor në projektet e zhvillimit; ▪ Mungesa e fondeve për zbatimin e planeve brenda afateve të planifikuara; ▪ Mbivendosja e strategjive apo planifikimit pa finalizuar pararendësin; ▪ Mungesa e buxhetimit për shërbimin e ekosistemeve; ▪ Buxheti i limituar i bashkive;

Autoritetet vendore, kanë një rol shumë të rëndësishëm në zbatimin e procedurës së VSM-së dhe në përmbushjen e detyrimeve për informimin dhe pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje mjedisore, veçanërisht për sa i përket hartimit të planeve dhe programeve që janë objekt i procesit të VSM-së, si edhe për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga paketa e ligjore për VNM-në për projekte të mëdha publike.



IV. SHFRYTËZIMI I QËNDRUESHËM I BIODIVERSITETIT OBJEKTIVAT, PLANI I VEPRIMEVE, PERFUNDIME DHE REKOMANDIME

4.1. Shfrytëzimi i qëndrueshëm i biodiversitetit

Në territorin e Bashkisë së Shkodrës për shkak të klimës, tokës së butë, burimeve natyrore të ujrave të ëmbla ka kushte të favorshme edhe për banimin e njerëzve. Ky rajon është banuar që nga prehistoria dhe të gjitha fazat e tjera të qytetërimeve të njerëzimit në Evropën Jugore kanë lënë gjurmë në këtë territor. Territoret me vlera natyrore në përgjithësi, si dhe ato me vlera të larta të biodiversitetit në veçanti, janë parë jo vetëm si shumë ndihmëse, por si të pandara nga zhvillimi i shumë ekonomive lokale. **Shumë nga vlerat e biodiversitetit shfrytëzohen në mënyrë të drejtpërdrejtë.** Një prej sektorëve ekonomike të zhvilluar ka qënë peshkimi. **Popullsia lokale e zonave rreth Liqenit e Lumit Buna, por edhe në zonën e Lagunës së Vilunit, merret me peshkim për konsum familjar dhe tregti. Zonat e moçaleve rreth Liqenit sigurojnë mundësinë më të mirë për pllenimin e krapit, një lloj ky komercial shumë i rëndësishëm dhe me interes ekonomik e turistik.**

Përfitim i drejtpërdrejtë ekonomik nga shfrytëzimi i biodiversitetit është **përdorimi i pyjeve** dhe i katit të nënpyllit si dhe i bimëve tanifere. Pyjet e zonës janë shfrytëzuar për lëndë për ngrohje por edhe si material ndërtimi.

Bimët mjekësore janë një tjetër kategori e biodiversitetit me shumë vlerë për përfitime ekonomike. Aktivitetet e biznesit të grumbullimit apo të përpunimit të këtyre bimëve janë akoma të limituara. Numërohen rreth 9 biznese të vogla dhe pak individë që punojnë për grumbullimin dhe tharjen e bimëve mjekësore si sherbela, çaji i malit, apo etoro-vajoret të por përpunimi i tyre në rajon mbetet sfidë për mungesë të teknologjive dhe kapaciteteve të përpunimit. *Ndërkohë në shkallë vendi, sektori i bimëve mjekësore aromatike (BMA), është kontribuesi i dytë i eksporteve bujqësore.*

Shpesh zonat me vlera natyrore kanë edhe vlera të shërbimeve jo të drejtpërdrejta që ato ofrojnë për komunitetet që jetojnë në to. Këtu mund të pohojmë faktin që zonat ligatinore shërbejnë si parandaluese të përmytjeve. Përmytjet në zonat moçalishte janë një dukuri e rregullt në sezone dhe vegjetacioni i zonave të lagëta është filtri fillestar i mbajtjes së ujrave. Liqeni i Shkodrës cilësohet si një nga torfat më të rëndësishme të Evropës Juglindore ndaj duhet ruajtur nga efektet afatgjata të ndryshimeve klimatike.

Vlerat rekreative dhe estetike të biodiversitetit të rajoneve brenda Bashkisë së Shkodrës janë shfrytëzuar dhe mund të vazhdojnë të shfrytëzohen për shkak të peizazheve, zonave ishullore, pasurisë së biodiversitetit si dhe elementëve kulturorë të shtuar në rrjedhën e viteve për shkak të ngritjes së fshatrave piktoreske si në Liqen e Bunë, ashtu edhe në zonën malore të Thethit. Vizitorët i tërheq peizashi, lundrimi si dhe ecjet në natyrë, vëzhgimi i zogjve që mund të jetë një premisë shumë e mirë për zhvillimin e ekoturizmit. Ky tip i turizmit të qëndrueshëm mund të jetë një premisë shumë e mirë për pasurimin edhe të komuniteteve lokale dhe zonave të mbrojtura.

Turizmi në nivel ndërkombëtar, konsiderohet si një industri shumë e rëndësishme që me potencialin e vet ka kontribuar dhe kontribuon në zhvillimin ekonomik. Që ai të ndikojë edhe në zhvillimin e qëndrueshëm duhet të merren në konsideratë dhe të zbatohen dy parime bazë, të cilat lidhin qëndrueshmërinë e zhvillimit me ekoturizmin: prurjet për ekonominë lokale dhe mbështetja në ruajtje të mjedisit.

Ekoturizmi, ose ndryshe turizmi që zhvillohet në zonat e mbrojtura me ligj, apo në zonat me vlera natyrore, vitet e fundit është përhapur shumë. Ky lloj turizmi edhe në vendin tonë po bëhet gjithnjë e më shumë i pranishëm, pasi fluksi i turistëve sa vjen e po priret drejt këtyre zonave. Ekoturizmi arrin të gjenerojë të ardhura të larta e të vazhdueshme për ekonominë vendore dhe rajonale, po në të njëjtën kohë ai synon që të nxitë qëndrimin publik dhe atë zyrtar në drejtim të ruajtjes së mjedisit. Të ardhurat kryesore që realizohen nga ekoturizmi janë taksat e hyrjes në këto zona, si dhe shpenzimet që turistët kryejnë brenda tyre. Këto të ardhura janë një burim për mbështetjen e studimeve ekologjike në këto zona, por në shumicën e rasteve ato janë të pamjaftueshme, pasi parqet që ndodhen nën administrimin publik kanë taksa mjaft të ulëta, ose nuk kanë fare.

Për të zhvilluar ekoturizmin dhe për ta bërë atë një faktor të rëndësishëm ekonomik, duhet të sigurohen shërbimet bazë të transportit, përmirësimi i infrastrukturës, si dhe kushtet e qëndrimit, në mënyrë që edhe kërkesa për këtë lloj turizmi në të ardhmen të jetë edhe më e madhe. Kështu, duke vlerësuar potencialin natyror të zonave të veçanta të rajonit tonë, bukuritë peisazhike por edhe atraksionet e trashëgimisë natyrore e kulturore mund të thuhet se Shkodra ka premisa të medha për zhvillimin e ekoturizmit.

Agroturizmi; Brian Ford, një biolog, hulumtues anglez shprehej se “ E kaluara është në kokën tuaj (memorie), ndërsa e tashmja në dorën tuaj”. Pra e kaluara është një kujrim por gjithashtu një pjesë e rëndësishme e saj. Këto kujtime na qartësojnë për të mos u përballur me gabimet që kemi bërë apo mundësitë që kemi humbur.

Pra nëse analizojmë të djeshmen e agroturizmit në Shqipëri, përfshihen dy sektorë atë që lidh bujqësinë me turizmin. Bujqësia është sektori më i vjetër i cili zhvillohet prej mijra vitesh, lidhur me turizmin ai është shfaqur në forma të ndryshme në vendin tonë por edhe në rajonin tonë, kështu mund të përmendim fillimin e viteve 1900 kur “ Edit’ h Durham në librin “ Shqipëria e lartësive dhe kufijtë e saj” përshkruan mikpritjen dhe bukuritë e veriut të Shqipërisë, pikërisht rajonit tonë.

Sot agroturizmi është një subjekt që bashkëpunon me një kompleks aktorësh, si një sipërmarrje e vecantë, kjo ndikon në zhvillimin e komuniteteve në zonat rurale dhe ndërlihd më së miri bujqësinë, turizmin dhe mjedisin vecanërisht biodiversitetin e zonës ku zhvillohet.

Kështu në Parkun Kombëtar të Alpeve deri në fund të gushtit 2024 patur mbi 300 mijë vizitorë. Menaxhimi i një fluksi të tillë është një sfidë e madhe për të gjithë aktorët ku : mjafton të zhvillojmë një agroturizëm që është në harmoni me burimet autentike, historinë, traditën, kuzhinën dhe mbi të gjitha një biodiversitet pa ndërhyrjen e njeriut, kështu shtrohet rruga për një zhvillim të qëndrueshëm në harmoni me resurset tona.






Figura 21. Harta e mundësive të shfrytëzimit të eco turizmit (Burimi:Strategjia territoriale e Planit të Pergjithshëm Vendor, Bashkia Shkodër, 2016)

Disa nga praktikat që mund të aplikohen në mbështetje të agroturizmit dhe ekoturizmit në Bashkinë Shkodër janë prezantuar më poshtë:

1. Ndërtimet e platformave natyrore për vëzhgimin zogjve në afërsi të Deltës së Lumit Buna, Liqenit të Shkodrës etj;
2. Ndërtimin e shtigjeve natyrore për aplikimin e eko-guideve dhe aktiviteteve në natyrë;
3. Zhvillimin e sporteve;
4. Ngritja e eko-fermave dhe strukturave agroturistike si dhe atyre eko-sociale në Bashkinë Shkodër;
5. Ngritja e shtëpive mikpritëse në breg të Liqenit (Shirokë e Zogaj) si dhe në zonat malore (Theth);
6. Përfshirje e ekoturizmit dhe agroturizmit në paketat turistike të rajonit;

7. Krijimi i regjistrit dhe hartave të Sistemit Informativ Gjeografik (GIS) për prodhuesit e produkteve artizanale në zonë;
8. Zhvillimi i produktit biologjik (bujqësor e blegtoral) të markuara dhe të certifikuara;
9. Krijimi i subvencioneve për paketat ekoturistike dhe agroturistike;
10. Krijimi i rrjeteve për eko dhe agro-aktivitete
11. Aktivitete për të promovuar traditën ekologjike në ushqim;
12. Kultivimi i bimëve tradicionale dhe rikthimi tek tradita;

Edukimi mjedisor

1. Edukimi mjedisor i nxënësve dhe i prindërve të tyre;
2. Aksione vullnetare me në fokus edukimin mjedisor;
3. Kultivimi tek njerëzit i sjelljeve miqësore me mjedisin.

Rehabilitimi i mjediseve natyrore dhe minimizimi i ndotjes

1. Menaxhimi i mbetjeve urbane dhe ujërave të përdorur;
2. Rregullime urbane të planifikuara dhe të mirë-studiuara;
3. Përdorimi i burimeve natyrore në favor të mjedisit.

Ngritja e kapaciteteve manaxhuese në ekoturizëm dhe agroturizëm

1. Specializim i studentëve në këto fusha;
2. Trajnim i fermëreve dhe ngritja e kapaciteteve të tyre;
3. Forcimi i kapaciteteve të specialistëve të fushës së mjedisit dhe turizmit.

Aksione alternative në zonat e mbrojtura

1. Ruajtja e florës dhe faunës në territorin e zonave të mbrojtura;
2. Shfrytëzim i qëndrueshëm i katit të nënpyllit;
3. Krijimi i kooperativave dhe fermave ekosociale;
4. Krijimi i zinxhirit të produkteve në shumë zona të mbrojtura.

4.2 Objektivat strategjike të PLMB

Në përmbushje të detyrimeve dhe në ofrimin e zgjidhjeve afatgjatë, afatmesme dhe afatshkurtra, ky plan parashtron disa objektiva për përmirësimin dhe ruajtjen e biodiversitetit si një ndër elementet më të rëndësishëm të mjedisit. Objektivat strategjike janë rrjedhojë logjike e



identifikimit të problematikave të biodiversitetit në nivel lokal por edhe kombëtar e global, pasi degradimi dhe kërcënimet ndaj biodiversitetit janë fenomene që reflektohen në trajtë zinxhiri. Mbështetur në analizën e identifikimeve, plani i mbrojtjes së biodiversitetit për Bashkinë Shkodër parashtron këto objektiva strategjike:

1. **Zhvillimi i kornizës ligjore dhe institucionale sipas standardeve të BE-së, nëpërmjet zbatimit të konventave ndërkombëtare të ruajtjes së biodiversitetit, në të cilat Shqipëria është pjesë.**
2. **Sigurimi i mbrojtjes së integruar të mjedisit përmes bashkëpunimit me sektorët tjerë.**
3. **Ndërthurja e parimeve dhe i politikave të nevojshme për përdorimin e qëndrueshëm të biodiversitetit.**
4. **Përcaktimi i praktikave më të mira menaxhuese në mënyrë që të krijohet një mbështetje e re në drejtim të ruajtjes së biodiversitetit.**
5. **Nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm dhe ekoturizmit në territorin e Bashkisë Shkodër.**
6. **Përditësimi dhe integrimi i informacionit mjedisor me atë të biodiversitetit.**
7. **Zgjerimi i zonimit të zonave të mbrojtura.**
8. **Integrimi i kurrikulave mjedisore për një edukim më të mirë mjedisor të komunitetit.**
9. **Rritja efektive e pjesëmarrjes së publikut në planifikim, vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe dëgjesa publike për projekte që kanë ndikim në biodiversitetin e zonës.**

4.3. Objektivat specifike afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata

Ruajtja e llojeve dhe ekosistemeve me vlera natyrore për biodiversitetin e Shkodrës është domosdoshmëri për sigurimin e ekonomisë së qëndrueshme të komuniteteve që banojnë rreth këtyre ekosistemeve si dhe sigurimin e jetës biologjike për të ardhmen e qëndrueshme të ekosistemeve ujore dhe atyre tokësorë. Ndaj, dhe objektivat specifikë të mbrojtjes së biodiversitetit për Bashkinë Shkodër janë hartuar si më poshtë:

1. **Mbajtja nën kontroll e shfrytëzimit të tokës dhe resurseve të saj si dhe parandalimi i vazhdueshëm i erozionit dhe degradimit të pyjeve;**
2. **Reabilitimi i brigjeve të lumore dhe monitorimi e kontrolli i nxjerrjes së inerteve;**
3. **Ruajtja e biodiversitetit llojor brenda territorit të ekosistemit urban të Bashkisë Shkodër;**
4. **Nxitja e ekoturizmit si një shërbim i ekosistemit me impakt të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik e social;**
5. **Promovimi i produkteve të pastra biologjike në tregjet e Shkodrës;**

Objektivat specifike afatgjata

1. **Ulja e sasisë së karbonit, nëpërmjet pyllëzimit dhe ripyllëzimit, objektiv ky i vendosur sipas dakordësisë së palës shqiptare për zbatimin e protokollit të Kiotos;**
2. **Sigurimi i përfitimeve ekonomike nga ekosistemi urban i Shkodrës si dhe ruajtja e parametrave të biodiversitetit brenda treguesve të qëndrueshmërisë;**
3. **Sigurimi i shfrytëzimit të qëndrueshëm dhe afatgjatë i vlerave të biodiversitetit në territorin e Bashkisë së Shkodrës;**
4. **Ruajtja e llojeve endemike dhe sub-endemike të gjallesave bimore e shtazore të përfshira në listat e kuqe të Shqipërisë e Ballkanit;**
5. **Nxitja e trendit për të zvogëluar gjurmën ekologjike në ekosistemin urban të Shkodrës.**



MATRICA E ZGJIDHJEVE/ RISHIKUAR :

Nr	Aspekti	Lloji i masës	PERSHKRIMI I MASES	INSTITUCIONI/ ENTE QE BASHKEPUNOJNE PER ZBATIMIN E MASES	RENDESIA	EFEKTI I MASES
Aspekti: Parandalimi dhe Informimi						
1	Instrument administrativ	Shpalljen e pellgut ujëmbledhës të liqenit të Shkodrës një zonë UNESCO në kategorinë Rezervë Biosfere Ndërkufitare.	Rikualifikimi dhe përmirësimi i statusit të mbrojtjes për ekosistemin ligatinor Liqeni i Shkodrës. Dhenia e statusit Rezervë Biosfere Ndërkufitare.	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Bashkia Shkodër, EDEN, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Northern Region Development, National Parks of Montenegro Komuniteti, etj.	1	Mbrojtja e biodiversitetit, përmirësimi i cilësisë biologjike të jetës, shfrytëzimi i qëndrueshëm i vlerave dhe rritje e vëmendjes së donatorëve.
2	Instrument administrativ	Vlerësimi i resurseve gjenetike për llojet kryesore pyjore.	Ruajtja dhe trajtimi i pyjeve të virgjëra ose pothuajse të virgjëra, grumbujve dhe drurëve pyjorë të veçantë, të cilësuar të virgjër ose pothuajse të virgjër.	Bashkia, AKZM/ADZM shoqatat e pyjeve, komuniteti, donatorë, etj.	1	Krijimi dhe rigjallërimi i rrjetit të integruar të rezervave gjenetike për llojet kryesore pyjore të përcaktuara në planin e mbarëshimit të ekonomive Pyjore.
3	Instrument administrativ	Rritja e ndërgjegjësimit mbi mbrojtjen e biodiversitetit.	Analizat, këshilla të synuara për bujqësinë dhe pylltarinë për menaxhim të qëndrueshëm, evente për informimin e publikut.	Bashkia/ NJA/ Shoqata/ Komuniteti/Donatorë.	1	Konsultimi me ekspertët e bujqësisë dhe pylltarisë.
4	Instrument administrativ	Zbatimi i Planit të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet, pjesë e territorit të Bashkisë Shkodër.	Menaxhimi në mënyrë të harmonizuar rrezikun nga përmbytjet.	Bashkia/NJA/AMBU/Ministri të perkatese/donatore.	1	Marrja e masave efektive, me qëllim parandalimin dhe reduktimin e pasojave të mundshme negative nga përmbytjet për shëndetin e njeriut, mjedisin, në zonat respektive.
5	Instrument administrativ	Zbatimi e Planeve të menaxhimit të Zonave të Mbrojtura, pjesë e territorit të Bashkisë Shkodër.	Bashkëpunimi për zbatimin e planeve të menaxhimit si detyrim ligjor i të gjithë aktorëve të përfshirë.	Bashkia, AKZM/ADZM, shoqatat e pyjeve, komuniteti, donatore, etj.	1	Zonimi është një mjet i rëndësishëm në përcaktimin e objektivave dhe kufizimeve për përdorimin e territorit, në një
6	Instrument administrativ	Mbrojtja e biodiversitetit në fushat aluvionale, zonat ujëmbledhëse, si edhe zonat pyjore dhe ato të mbrojtura.	Rritja e ndërgjegjësimit të komunitetit mbi rëndësinë e biodiversitetit; Parandalimit dhe mbrojtjes nga përmbytja; parandalimit të zjarreve në pyje me anë të komunikimit në ambientet publike në bashki, në njësitë administrative, në vende publike të institucioneve të tjera që ofrojnë shërbime ndaj publikut, vende publike, etj.	Bashkia/NJA/AMBU/Ministri të perkatese/donatorë.	1	Mbrojtja e biodiversitetit, përmirësimi i cilësisë së jetës, shfrytëzimi i qëndrueshëm i vlerave jo vetëm të biodiversitetit por edhe vlerave natyrore, mjedisore dhe ekonomike të zonës.
Aspekti: Mbrojtja teknike						
1	Mbrojtje teknike	Ndertimi i impiantit të trajtimit të ujërave të zeza Bashkia Shkodër.	Ujërat e përdorura të grumbulluara nga sistemi i K.U.Z. i qytetit të Shkodrës shkarkohen aktualisht pa asnjë lloj (para) trajtimi. Zgjerimi i zonave të urbanizuara apo të lidhura me rrjetin e KUZ është rritur dhe ndikimi në përshpejtimin e keqësimit të cilësisë së ujërave rritet.	Bashkia Shkodër, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Biznesi vendas, Programe & Donatorë.	1	Parandalimi i përkeqësimit, mbrojtja dhe, kur është e mundur, përmirësimi i mjedisit ujor. Zbatimi i trajtimit eficient të ujërave të zeza është detyrim ligjor. Ndertimi i këtij impianti do të sjellë përmirësim të cilësisë së ujërave, e shoqëruar me një performancë pozitive në rritje në të gjithë parametrat mjedisore e përzjedhjeve edhe të biodiversitetit.
2	Mbrojtje teknike	Identifikimi, studimi dhe miratimi i fushës së depozitimit të mbetjeve të ngurta në Bashkinë Shkodër.	Identifikimi, studimi dhe miratimi i fushës së depozitimit të mbetjeve të ngurta në Bashkinë Shkodër. Ndërtimi dhe menaxhimi i vend depozitimit të mbetjeve të ngurta.	Bashkia Shkodër, Ministria e Transportit dhe Infrastruktures, Biznesi vendas, Programe & Donatorë	1	Shmangia e ndotjeve të ngurta, përmirësimi i cilësisë së jetës biologjike dhe qytetarëve të Bashkisë Shkodër. Reduktimi i sasisë së depozitimit të mbetjeve të ngurta në vende të pa kontrolluara, shmangia e ndotjes nga Burimet e Shpërndara.

3	Mbrojtje teknike	Mbrojtja e zonave përgjatë brigjeve të lumit.	Mbjellja e shelgjeve, akacieve dhe plepave në zonat përgjatë anës së lumit për të zvogëluar erozionin.	Bashkia Shkodër, AKP/MTM	1	Mbrojtja e tokës nga erozioni dhe parandalimi i përmbytjeve të cilat ndikojnë në ruajtjen e biodiversitetit.
4	Mbrojtje teknike	Rehabilitimi, pyllëzim dhe ripyllëzim të sipërfaqeve të degraduara, djegura dhe rehabilitimin e kullotave nëpërmjet praktikave silvo-pastorale.	Parandalimit të gërryerjes së mëtejshme të tokës pyjore dhe kullosore.	Bashkia Shkodër, AKP/MTM	1	Hartimi i Planeve të Menaxhimit të Pyjeve/kullotave dhe projekteve të vecanta për pyllëzim/ripyllëzim etj. E shprehur në numër planesh gjithsej 11 ose për 30.666,3 ha pyje/kullota.
5	Mbrojtje teknike	Nxitja e rigjenerimit natyror dhe rigjenerimi me lloje autoktone të drurëve pyjore.	Pyllezimi i sipërfaqeve pyjore me lloje autoktone të drurëve pyjore si dhe pemëve të frutave të pyllit sic është gështenja.	Bashkia Shkodër, AKP/MTM/ MBZHR	1	Rigjenerimi natyror dhe ndikimi pozitiv në biodiversitet.
6	Mbrojtje teknike	Ruajtja dhe trajtimi i pyjeve të virgjëra.	Përcaktimi në Planet e Mbarëshimit të Pyjeve pothuajse të virgjëra, grumbujve dhe drurëve pyjorë të veçantë, të cilësuar të virgjër ose pothuajse të virgjër.	Bashkia Shkodër, AKP/MTM/	1	Ndikim të drejtpërdrejtë në mbrojtjen e biodiversitetit të zonave pyjore në përgjithësi.

Aspekti: Mbrojtja natyrore/Mbajtja nën kontroll e shfrytëzimit të tokës në përgjithësi dhe asaj bujqësore e pyjore në veçanti

1	Mbrojtje natyrore	Mbrojtja e fushave aluvionale dhe zonave ujëmbajtëse, Zonave të Mbrojtura si edhe ato Pyjore.	Kufizime dhe rregullore për përdorimin e tokës në fusha aluvionale të cilat mund të shkaktojnë rreziqe të reja apo të cilat sjellin efekte negative në lidhje me biodiversitetin. Mbrojtje me anë të kufizimeve për ndërtim.	Bashkia/NJA/AMBU/Ministri të perkatese/ donatorë	2	Vlerësimi mjedisor i zonave të rrezikuara, për të orientuar institucionet përgjegjëse për të vlerësuar gjendjen e mjedisit përpara vendimeve për përdorimin e tokës etj.
2	Mbrojtje natyrore	Promovimi i ndryshueshmërisë bujqësore.	Përshtatja e përdorimit ekzistues të tokës në zonat e rrezikuara (duke përfshirë bujqësinë dhe pylltarinë).	Bashkia Shkodër, AKP/MTM/ MBZHR	2	Zhvillimi i përdorimit të përshtatur të tokës në zonat e rrezikuara, si shndërrimi afatmesëm i tokës bujqësore në kullota të gjelbërta të përhershme, ndryshimi i metodave të prodhimit (p.sh. mbrojtja e tokës) dhe i përdorimit të makinerive.
3	Mbrojtje natyrore	Nxitja dhe inspirimi i ndryshueshmërisë bujqësore.	Përmes përpunimit, etiketimit rajonal, paketimit, apo përpjekje të tjera për të rritur produktin.	Bashkia Shkodër, AKP/MTM/ MBZHR	2	Realizimin e një projekti pilot për fermerët dhe të tjerët, që shtojnë vlerën e produkteve, përmes përpunimit, etiketimit rajonal, paketimit apo përpjekje të tjera për të rritur produktin.
4	Mbrojtje natyrore	Rivlerësimi dhe vlerësimi i certifikimit të produkteve pyjore që ndodhen në luginën e Kirit (Gështenjë).	Realizimin e një projekti pilot për: Certifikimin e produkteve pyjore të cilat premtojnë "biodiversitet miqësor".	Bashkia Shkodër, AKP/MTM/ MBZHR	2	Promovimi i produktit autokton duke përmirësuar jo vetëm cilësinë e jetës, rritjen ekonomike por edhe ndikim pozitiv mjedisor.
5	Mbrojtje natyrore	Sistemim ambiental, pastrimi dhe mirëmbajtja e brigjeve lumore.	Ndërhyrje në 168.7 km vijë lumore.	Bashkia Shkodër/ AKZM/ADZM/MTM/MBZHR/AMBU/Donatorë/Shoqata	2	Parandalimi i përkeqësimit, mbrojtja dhe, kur është e mundur, përmirësimi i jo vetëm mjedisit ujor por edhe mbrojtja e tokës nga erozioni; Të gjitha bashkë me një ndikim pozitiv në biodiversitet.
6	Mbrojtje natyrore	Nxitja dhe promovimi i përdorimit të energjive të rinovueshme duke shkuar drejt energjisë zero.			2	



V. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

5.1 Përfundime

Në përfundim të hartimit të këtij studimi mund të pohojmë:

- Uniteti ekologjik i zonës së Shkodrës (përfshi të gjitha ekosistemet natyrore) nënvizon nevojën për një qasje gjithëpërfshirëse ndër-institucional për ruajtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të këtij rajoni;
- Burimet natyrore dhe veprimtaritë e zhvillimit në zonë, menaxhohen dhe kontrollohen nga struktura të ndryshme, detyrat dhe përgjegjësitë e të cilëve janë ndonjëherë të mbivendosura dhe jo të qarta. Është e nevojshme që të vendosen funksione dhe përgjegjësi të qarta për secilën strukturë manaxhuese që vepron në zonë;
- Statusi aktual i ekosistemit Liqeni i Shkodrës – Lumi Buna kërkon rishikim dhe ndryshim në një kohë jo më të gjatë se dy-vjeçare drejt shpalljes Park Kombëtar;
- Zbatimi i Praktikave më të mira menaxhuese përmes përfshirjes së të gjithë aktorëve, janë mekanizma të domosdoshme për ruajtjen dhe mbrojtjen e vlerave dhe diversitetit biologjik të këtij rajoni i njohur dhe listuar në listën e zonave me rëndësi ndërkombëtare;
- Kostoja financiare e përlogaritur për zbatimin e të gjitha Praktikave të propozuara në këtë Plan është vlerë mjaft e përfaqshme dhe ka karakter orientues, pasi përlogaritja kërkon detaje shtesë dhe në disa raste ekspertizë të thelluar inxhinierie;
- Harku kohor i parashikuar për zbatimin e Planit për mbrojtjen e biodiversitetit 2025 – 2032 është në varësi të gjetjes së fondeve pasi tre nga prioritetet e këtij plani kërkojnë kosto të larta për zbatim;

Shtojca

- Aneksi 1
- Aneksi 2
- Bibliografia
- Foto të specieve
- Baza ligjore per ruajtjen dhe mbrojtjen e biodiversitetit



ANEKS I: LISTA E SPECIEVE TË BIMËVE NË PELLGUN UJOR TË SHKODRËS

Lista e specieve të bimëve në pellgun ujor të Shkodrës	
Emri shkencor	Emri në shqip
<i>Acer monspessulanum</i>	Krekëza fletëngushtë
<i>Agrostis alba</i>	Barimëzame stolone
<i>Agrostis canina</i>	Barimza e qenit
<i>Alisma plantago - aquatica</i>	Këlkoja e ujit
<i>Alnus glutinosa</i>	Verri i zi
<i>Alopecurus rendlei</i>	Pungaca me kacekth
<i>Beckmannia eruciformis</i>	Bekmania si vemje
<i>Bidens cernua</i>	Dydhëmbëshi i varur
<i>Bidens tripartita</i>	Dydhëmbëshi trepjesësh
<i>Butomus umbellatus</i>	Bliqini
<i>Caldesia parnassifolia</i>	Kaldesia gjethe parnasie
<i>Callitriche stagnalis</i>	Kalitriku i pellgjeve
<i>Callitriche verna ?</i>	Kalitriku pranveror
<i>Carex pseudocyperus</i>	Presja zubërreme
<i>Carex riparia</i>	Presja e buzëujit
<i>Carex acuta</i>	Presja me majë
<i>Carex distans</i>	Presja e larguar
<i>Carex paniculata</i>	Presja melthore
<i>Ceratophyllum demersum</i>	Gjethebriri i zhytur
<i>Ceratophyllum submersum</i>	Gjethebriri gati i zhytur
<i>Chaetophora pisciformis</i>	Ketofora si peshk
<i>Chaetophora incrassata</i>	Ketofora e trashur
<i>Chara fragilis</i>	Hara e brishtë
<i>Chara fragifera</i>	Hara me thyerje
<i>Chara vulgaris</i>	Hara e rëndomtë
<i>Chara rudis</i>	Hara purtekë
<i>Chara Kokeilii</i>	Hara e Kokeilit
<i>Chara tenuisiima</i>	Hara e vogël
<i>Chara aspera</i>	Hara e ashpër
<i>Chara connivens</i>	Hara picëruese
<i>Cladium mariscum</i>	Kladi fik i egër
<i>Crataegus monogyna</i>	Murrizi njëbërthamor
<i>Eleocharis palustris</i>	Heleohari i kënetës
<i>Epilobium hirsutum</i>	Epilobi me qime
<i>Epilobium palustre</i>	Epilobi i kënetës
<i>Equisetum fluviatile</i>	Këputje e lumit
<i>Equisetum palustre</i>	Këputje e kënetës
<i>Eupatorium cannabinum</i>	Eupatori kërpore
<i>Euphorbia palustris</i>	Rilla e kënetës
<i>Fraxinus angustifolia</i>	Frashri gjethengushtë
<i>Fontinalis antipyretica</i>	Shatërvanja antipiretike
<i>Galium palustre</i>	Ngjitësja e kënetës
<i>Glyceria aquatica</i>	Gliqeri i ujit
<i>Glyceria fluitans</i>	Gliqeri pluskues
<i>Gratiola officinalis</i>	Dërnoku mjekësor
<i>Greolandia densa</i>	Groelandia e shpeshtë
<i>Hippuris vulgaris</i>	Hipuri i rendomtë
<i>Holoschoenus vulgaris</i>	Zuba e rendomtë
<i>Hydrocharis morsus</i>	Lapagrethi i bretkocës
<i>Hydrocotyle vulgaris</i>	Hidrokotili i rendomtë

<i>Iris pseudocorus</i>	Badra e ujit
<i>Juncus effusus</i>	Zhuga e butë
<i>Juncus acutus</i>	Zunkthi i butë
<i>Juncus articulatus</i>	Kulmaku i nyjëtuar
<i>Juncus conglomeratus</i>	Kulmaku në tufë
<i>Lemna minor</i>	Manërosa e vogël
<i>Lemna gibba ?</i>	Manërosa gungaçe
<i>Leucojum aestivum</i>	Zëmbaku i kënetës
<i>Lippia nodiflora</i>	Lipja lulenyje
<i>Ludwigia palustris</i>	Ludvigia e kënetës
<i>Lychnis flos - cuculi</i>	Lulengjitësja luleqyqe
<i>Lythopus europaeus</i>	Këmbëujku european
<i>Lythrum hyssopifolia</i>	Barëgjaku gjethehisop
<i>Lythrum flexuosum</i>	Barëgjaku i përkulshëm
<i>Lythrum salicaria</i>	Barëgjaku shelgjesh
<i>Lysimachia vulgaris</i>	Lisimakia e rendomtë
<i>Lysimachia nummularia</i>	Bargjergji
<i>Marsilea quadrifolia</i>	Marsilea katërgjethëshe
<i>Mentha aquatica</i>	Mendra e ujit
<i>Molinia coerulea</i>	Molina e kaltërt
<i>Mougeotia sp.</i>	Muzhegotia
<i>Myosotis scorpioides</i>	Lulemiza bishtakrep
<i>Myosotis sicula ?</i>	Lulemiza e varur
<i>Myriophyllum verticillatum</i>	Mijëgjethëshi qertullor
<i>Myriophyllum spicatum</i>	Mijëgjethëshi kalli
<i>Najas minor</i>	Lapagrethi i vogël
<i>Najas marina</i>	Lapagrethi i detit
<i>Nasturtium officinale</i>	Purqarku mjekësor
<i>Nitella gracilis</i>	Nitela e hollë
<i>Nitella batrachosperma</i>	Nitela farëbretkocë
<i>Nitella capillaris</i>	Nitela leshtake
<i>Nitella opaca</i>	Nitela e zeshkët
<i>Nitella syncarpa</i>	Nitela mbështjelljebashkuar
<i>Nitella confervacea</i>	Nitela e ndezur
<i>Nitella flexilis</i>	Nitela e përkulshme
<i>Nitella mucronata</i>	Nitela e thimthuar
<i>Nitellopsis obtusa</i>	Nitela e topitur
<i>Nuphar luteum</i>	Lëkua uji i verdhë
<i>Nymphaea alba</i>	Lëkua uji i bardhë
<i>Nymphoides peltata</i>	Nimfoidi shytak
<i>Oenanthe aquatica</i>	Barëujca
<i>Oenanthe fistulosa</i>	Luledhria fyll
<i>Orchis laxiflora</i>	Salepi luleçlirët
<i>Paspalum distichum paspalodes</i>	Krisja e ujit
<i>Phalaris arundinacea</i>	Kokëmadhja e kallamit
<i>Phragmites australis</i>	Kallamishtja
<i>Polygonum amphibium</i>	Nejca amfibe
<i>Populus alba</i>	Plepi i bardhë
<i>Potamogeton lucens</i>	Potamogetoni i ndritshëm
<i>Potamogeton perfoliatus</i>	Potamogetoni i përgjethur
<i>Potamogeton nodosus</i>	Potamogetoni me nyje
<i>Potamogeton natans</i>	Potamogetoni notues
<i>Potamogeton pectinatus</i>	Potamogetoni krehëror
<i>Potamogeton crispus</i>	Potamogetoni kaçurrel
<i>Potamogeton gramineus</i>	Potamogetoni gramor
<i>Potamogeton acutifolium</i>	Potamogetoni i Bertolit



Potamogeton pusillus	Potamogetoni i hollë
Pulicaria dysenterica	Plenëra e dizenterisë
Pycreus flavescens	Kashta e verdhë
Pycreus longus	Kashta e gjatë
Ranunculus aquatilis	Zhabina e ujit
Ranunculus baudotti	Zhabina e Baudotit
Ranunculus flammula	Zhabina flakore
Ranunculus ophioglossifolius	Zhabina gjethe gjuhë gjarpri
Ranunculus trichophyllus	Zhabina gjethe qimore
Ranunculus circinathus	Zhabina e spërdredhur
Ranunculus fluitans ?	Zhabina pluskuese
Rorippa amphibia	Roripa amfibe
Rorippa silvestris	Roripa e pyllit
Rubus ulmifolus	Manaferra
Sagittaria sagittifolia	Shtanga gjethe shpatë
Salix purpurea	Shelgu i kuq
Salix alba	Shelgu i bardhë
Salix fragilis	Shelgu i thyeshëm
Salix pentandra	Shelgu pesë thekësh
Salix incana	Shelgu thinjosh
Samolus valerandi	Samoli i valerandit
Schoenoplectus lacustris	Kryekuqja e liqenit
Serapis vomeracea	Serapia vjellëse
Sium latifolium	Siumi gjethegjerë
Sparganium ramosum	Sparganja e ngritur
Spirodella polyrhiza	Spirodela rrënjëshumë
Spyrogira sp.	Spirogira
Stachys palustris	Sarusha e kënetës
Tamarix parviflora	Marina lule vogël
Thalichtrum lucidum	Pipanola e ndritshme
Tolypella glomerata	Tolipela lëmshore
Tolypella prolifera	Tolipela me filiza
Trapa natans	Arra e ujit
Typha angustifolia	Shavari gjethegushtë
Typha latifolia	Shavari gjethegjerë
Utricularia minor	Utrikularia e vogël
Utricularia vulgaris	Utrikularia e rëndomtë
Vallisneria spiralis	Valisneria spirale
Vitex agnus-castus	Konopica
Zannichellia palustris	Xanikela e kënetës
Zygnema sp.	Zygnema

ANEKS 2: LISTA E SPECIEVE TË PESHKUT

EMRI SHKENCOR	EMRI SHQIP
PISCES	PESHQIT
<i>Acipenser naccarii</i>	Blini i Drinit
<i>Acipenser sturio</i>	Blini
<i>Anguilla anguilla</i>	Ngjala
<i>Alosa agone</i>	Kubla
<i>Barbatula zetensis</i>	Tufëza e Zetës
<i>Cobitis ohridana</i>	Mrena e egër e Ohrit
<i>Alburnoides ohridanus</i>	Barkgjera e Ohrit
<i>Alburnus scoranza</i>	Gjuca
<i>Barbus rebeli</i>	Mrena e Fanit
<i>Carassius gibelio</i>	Karasi prusian
<i>Chondrostoma nasus</i>	Njila
<i>Chondrostoma scodrensis</i>	Njila e Shkodrës
<i>Ctenopharyngodon idella</i>	Amuri i bardhë
<i>Cyprinus carpio</i>	Krapi
<i>Gobio skadarensis</i>	Mrena e Shkodrës
<i>Hypophthalmichthys molitrix</i>	Ballëgjeri i bardhë
<i>Hypophthalmichthys nobilis</i>	Ballëgjeri laraman
<i>Megalobrama terminalis</i>	Pellëmbëza e zezë
<i>Mylopharyngodon piceus</i>	Amuri i zi
<i>Pachychilon pictum</i>	Skorta e zezë
<i>Parabramis pekinensis</i>	Pellëmbëza e bardhë
<i>Pelagus minutus</i>	Grunci i vogël
<i>Phoxinus lumaireul</i>	Cigani italian
<i>Pseudorasbora parva</i>	Notaku
<i>Rhodeus amarus</i>	Idhnaku
<i>Rutilus karamani</i>	Skorta e Drinit
<i>Rutilus ohridanus</i>	Skorta e Ohrit
<i>Scardinius knezevici</i>	Lloska e Shkodrës
<i>Squalius platyceps</i>	Mlyshi kokështypur
<i>Telestes montenigrinus</i>	Mlyshi malazet
<i>Tinca tinca</i>	Lina
<i>Gambusia holbrooki</i>	Barkuleci
<i>Gasterosteus gymnurus</i>	Gjembraçi
<i>Liza ramada</i>	Qefulli i vjeshtës
<i>Mugil cephalus</i>	Qefulli i verës
<i>Salaria fluviatilis</i>	Barburiqi i lumit
<i>Pomatoschistus montenegrensis</i>	Burdullaku i Shkodrës
<i>Dicentrarchus labrax</i>	Levrek
<i>Perca fluviatilis</i>	Sharmaku
<i>Sander lucioperca</i>	Sharmaku heshtor
<i>Citharus linguatula</i>	Paroshja
<i>Platichthys flesus</i>	Shojza
<i>Oncorhynchus mykiss</i>	Trofta e ylbhtë
<i>Salmo dentex</i>	Trofta e gjuhçës
<i>Salmo farioides</i>	Trofta e Drinit
<i>Salmo marmoratus</i>	Trofta e mermertë
<i>Salmo montenegrinus</i>	Trofta malazeze
<i>Salmo obtusirostris</i>	Trofta buzë butë
<i>Salmo taleri</i>	Trofta e Zetës
<i>Salvelinus fontinalis</i>	Trofta e artë
<i>Thymalus thymallus</i>	Freskori
<i>Ameiurus nebulosus</i>	Peshk macja kafe



BIBLIOGRAFIA

- DEMIRI, 1983. Flora ekskursioniste e Shqipërisë, Tiranë.
- DHORA, DH. 2005. Makrofitet në “Liqeni i Shkodrës”. Fq. 67-89.
- DHORA, DH., SOKOLI, F. 1999. Biodiversiteti i liqenit të Shkodrës. GEF/sgp. Shkodër.
- DHORA, DH., KASHTA L. & HOTI M. 1996: Liqeni i Shkodrës. Shkodër.
- DHORA, DH. & RAKAJ, M. 2010: Lista e specieve të bimëve dhe kafshëve të Liqenit të Shkodrës (List of Plant and Animal Species of Shkodra Lake). Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” Shkodër, C & P. Fq. 96.
- KASHTA L. 1994: Kontribut për algaflorën e ujërave të ëmbla të Shqipërisë.- Bul. Shk. Nat. Shkodër nr.1:63-67.
- KASHTA L. 1996. Bimët e Liqenit. – Sektori i Bioekologjisë së Liqenit të Shkodrës. Shkodër, 24pp.
- KASHTA L. 1999. Përhapja e disa bimëve të rralla dhe të kërcënuara në Liqenin e Shkodrës. Bio & Eko, nr. 2: 7-10.
- KASHTA L., 2000. Mbi përhapjen e disa bimëve të rralla dhe të kërcënuara në hidrobiotope në afërsi të Liqenit të Shkodrës. – Bio & Eko, nr. 3: 12-16.
- RAKAJ, M. 2009: Neë macrophytes for the flora of Albania from the Lake Shkodra, Drini and Buna basins. J. Int. E nvironmental Application & science. Vol 4 (3): 278-284. Special Issue for Alblakes 09, Pogradec- Albania.
- RAKAJ, M. & KASHTA, L. 2010: Floristic and chrological records for monocots of the Lake Shkodra. Proceeding of ICE –Internacional Conference of Ecosystems, Albania, 4-6 Qershor 2001.
- RAKAJ, M. – Biodiversiteti 2009
- QOSJA, XH., PAPANISTO, K., DEMIRI, M., VANGJELI, J.& BALZA, E. 1992: Flora e Shqipërisë, Vol. 2. – Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Qendra e Kërkimeve Biologjike, Tiranë, 456pp.
- QOSJA, XH., PAPANISTO, K., VANGJELI, J.& RUCI, B. 1996: Flora e Shqipërisë, Vol. 3. – Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Qendra e Kërkimeve Biologjike, Tiranë, 331 pp.
- SOKOLI, F. 2003. Laguna e Vilunit GEF/sgp. Shkodër.
- Strategjia territoriale e Planit të Pergjithshëm Vendor, Bashkia Shkodër, 2016.
- Vleresimi Strategjik Mjedisor, i PPV-së, 2016.
- Dokumenti i Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit

FOTO TE SPECIEVE



Çafka e përhime



Çafka e Madhe





Gentiana Verna



Habitat me Trapa



Ëulfenia Baldaccii



Syri i Sheganit



Shoqërim bimor me shegë



Kredharaku Gushëzi





Kredharaku i Madh



Karabullaku i Detit



Pula e Ujit



Shapka e Ujit



Pulëbardha Këmbëverdhë



Korniza Ligjore dhe Prioritetet ne Fushën e Mbrojtjes së Biodiversitetit

Më poshtë prezantojmë kuadrin ligjor për mbrojtjen e larmisë biologjike dhe zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit në Shqipëri.

- Ligji nr. 9587, datë 20.07.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit” i ndryshuar (hyrja në fuqi 24.08.2006);
- Ligji nr. 68/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9587, datë 20.7.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, të ndryshuar 10.08.2014;
- Ligji nr. 10006, datë 23.10.2008 “Për mbrojtjen e faunës së egër”; (hyrja në fuqi 15.11.2008);
- Ligji nr.10 006, datë 23.10.2008 PËR MBROJTJEN DHE KONSERVIMIN E FAUNËS SË EGËR (ndryshuar me ligjet: nr.10 137, datë 11.5.2009, nr. 41/2013, datë 14.2.2013, nr. 46/2019, datë 18.7.2019)
- Ligji nr. 10253, datë 11.03.2010 “Për gjuetinë”(hyrja në fuqi 28.4.2010)
- Ligj nr. 43/2013 për disa ndryshime në ligjin nr. 10 253, datë 11.3.2010 “për gjuetinë”
- Ligji nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar, (hyrja në fuqi 30.12.2013);
- Ligj nr. 31/2013 Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”;
- Ligj nr. 156 date 10.10.2013 Për disa ndryshime ne ligjin nr.10463, date 22.9.2011 Per menaxhimin e integruar te mbetjeve;
- Ligji nr. 10463 22.09.2011 për menaxhimin e integruar të mbetjeve;
- Ligji nr. 32/2013 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 463, datë 22.9.2011 “për menaxhimin e integruar të mbetjeve;
- Ligj nr. 28/2022 për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 463, datë 22.9.2011, “për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar;
- Ligji nr. 91, datë 28.02.2013 “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor (hyrja në fuqi 04.04.2013);
- Ligji nr. 51/2023 për disa ndryshime në ligjin nr. 91/2013, “për vlerësimin strategjik mjedisor”;
- VKM nr. 247, datë 30.04.2014 “Për përcaktimin e rregullave dhe kërkesave të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore; (hyrja në fuqi 21.05.2014); (Shfuqizon VKM-ne nr.994)
- Vendim nr. 268, datë 27.4.2023 për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 247, date 30.4.2014, të këshillit të ministrave, “për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimindhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore;
- VKM nr. 994, datë 02.07.2008 “Për tërheqjen e publikut në vendimmarrje për mjedisin”; (hyrë në fuqi 24.07.2008)
- VKM nr. 866, datë 10.12.2014 “Për miratimin e listave të habitateve natyrore, bimëve, kafshëve dhe shpendëve me interes për Bashkimin Evropian”;
- Ligji nr. 8672, datë 26.10.2000 “Për Ratifikimin e Konventës së Aarhusit për të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t’iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit”; 10.11.2000
- Ligj nr. 84/2020 për pranimin e vendimit II/1 të palëve, që ndryshon “konventën e Aarhusit për të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t’iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit”, ratifikuar me ligjin nr. 8672, datë 26.10.2000 (per OMGJ-te)
- Ligji nr. 119/2014, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”; 02.11.2014;

- Ligj nr. 78/2023 për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 119/2014, “për të drejtën e informimit”
- VKM nr. 16, datë 04.01.2012 “Për të drejtën e publikut për të pasur informacion mjedisor”. 02.11.2014;
- Dokumenti i Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit Deri në vitin 2020;
- VKM nr. 246, miratuar me datë 30.04.2014 “Për përcaktimin e normave të cilësisë së mjedisit për ujërat sipërfaqësorë”;
- Ligji nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, ka transpozuar edhe disa prej dispozitave të Direktivës së Ujërave të Ndotur Urban.;
- Ligji nr. 111/2012 si më lart shfuqizuar nga Ligji nr. 29/2024 për burimet ujore (hyn në fuqi 25.10.2024);
- VKM nr. 267, datë 07.05.2014 “Për miratimin e listës së substancave parësore në mjediset ujore”;
- VKM nr. 63, datë 27.1.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”;
- VKM nr. 662, datë 21.09.2016 “Për miratimin e tarifave të përdorimit të ujit dhe të shkarkimeve të lëngëta”;
- VKM nr. 342, datë 4.05.2016 “Për miratimin e kufijve territorial dhe hidro-grafik të baseneve ujore në RSH dhe qendrën dhe përbërjen e këshillit të secilit prej tyre”;
- Vendim nr.696, datë 30.10.2019 për përcaktimin e kufijve territorialë, hidrografikë të baseneve ujore në republikën e shqipërisë dhe të qendrës e përbërjes së këshillit të secilit prej tyre; (shfuqizon ato me sipër)
- VKM nr. 416, datë 13.5.2015 “Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimmarrjes dhe formateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimeve ujore”;
- Ligji nr. 75, datë 14.07.2016 “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Parisit”. Angazhimet për reduktimin e emisioneve të Gazeve me Efekt Serrë (GES).

